



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Tetor 2008 • Viti XXV • Nr. 10 (168) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



HYJI KRIJUES DHE ZBULIMET E REJA SHKENCORE

FAQE 6-7

Shkruan:
DON PAL TUNAJ



FAMILJA EDUKON SOT? MISIONI I FAMILJES NË REALITETIN AKTUAL

FAQE 9

Shkruan:
DON LEKË OROSHI S.D.B.

MUAJI TETOR, MUAJ I KUSHTUAR ZOJËS RRUZARE

FAQE 11-12

Shkruan:
DON DAVID GJUGJA



Gjithë Shenjtërit – Ftesë për Shenjtëri

■ SHKRUAN:
Dr. Don Lush GJERGJI

Nderimi i shenjtërve, sidomos i martirëve, është pothuaj nga zanafilla e vetë krishterimit. Qysh nga gjysma e shekullit të parë pas Krishtit, kur përndjekjet romake ishin gati të vazhdueshme dhe tejet të rrepta, të krishterët i nderonin martirët si dëshmitarë të guximshëm të fesë, të pavdekësisë, dhe si flajimtarë të dashurisë me Jezu Krishtin, “*Martirin e Parë*”. Mbi varrezat e tyre tuboheshin të krishterët për t’i përkujtuar dhe për t’iu lutur atyre, për të marrë fuqi dhe frymëzim për jetën fetare, për sprovat dhe sfidat e ndryshme në vuajtje, përndjekje dhe martirizime. Kultu ndaj tyre nuk ishte më vetëm çështje familjare, lidhje gjaku, si ndër paganët, por e shprehte bindshëm fenë e bashkësisë së krishterë në jetën e pasosur si dhe në ndërmjetësinë e shenjtërve. Qysh atëherë **dies natalis** – ditëlindja për qiell dhe amshim, ishte dita e vdekjes dhe martirizimit, traditë që ka vazhduar gjatë shekujve dhe jetësohet gjithnjë në Kishë. Mbi varrezat e martirëve, më vonë edhe të shenjtërve jomartirë, populli i krishterë shtegonte gjithnjë, lutej, paraqiste dhurata, ndezte qirin, bile kremtohej shpesh edhe vetë eukaristia, mesha e shenjtë. Kjo traditë pas Ediktit të Milanos /313/ dhe lirisë fetare së shpejti qe begatuar edhe me ndërtimin e kapelave, kishave, më vonë edhe të bazilikave, kështu që kujtimi dhe përshtirja ndaj shenjtërve të mbeste gjithnjë e gjallë dhe e pranishme në jetën e krishterë. Përse ndodhi kjo dhe çfarë kuptimi ka? Sepse nëpërmjet martirëve, më vonë edhe shenjtërve tjerë, dëshmohej së pari prania, fuqia, mirësia e Zotit, mbi të gjitha fitorja e Jezusit të ngjallur mbi Djallin, mëkatit dhe vdekjes, misteri i shëlbimit, si dhe bashkëpunimi i tyre me hiri dhe ndërmjetësinë e tyre para Zotit për Kishën /*Krb. LG 41*/. Prandaj në përkujtimin dhe kremtimin e të Gjithë Shenjtërve si dhe lumturimin e Nënës Tereze (19.10.2003), Kisha edhe një herë kremton, falënderon, lavdëron Hyjin për dhurata, karizma dhe hire të ndryshme, si dhe na jep shembullin, modelin e shenjtërisë konkrete, gjatë shekujve. Në këtë ditë përkujtojmë dhe nderojmë apostujt dhe nxënësit e Jezusit, martirët e të gjitha vendeve dhe kohëve, virgjërat, fëmijët, rininë, burrat dhe gratë, meshtarët, rregulltarët dhe rregulltaret, të gjithë ata që kanë jetuar si ne në këtë botë, dhe janë shenjtëruar, e kanë arritur qëllimin kryesor të krijimit – **shëlbimin** nëpërmjet jetës së krishterë të mbështetur në fe, shpresë dhe dashuri. Festa e të Gjithë Shenjtërve në një mënyrë na mundëson “*shijimin*” e parrizit, jetës në lumturi me Zotin dhe me vëllezërit dhe motrat tona të lumturuar. Dikur kjo festë ishte më 13 maj për çdo vit /nga shënimet e Tertulianit, Gërgurit të Madh dhe Efremit/. Papa Bonifaci IV Panteonin e Romës ia kishte kushtuar Virgjërës Mari dhe të Gjithë Shenjtërve /13 maj 609/. Më vonë festa ishte caktuar më 1 nëntor për t’i mbuluar disa kremtime të besëtytnive pagane /në vitin 835/. Kjo Ditë së bashku me Ditën e Purgatorëve /Burgatorëve/, kujtimin e të gjithë të vdekurve, na fton edhe një herë ta përforcojmë të vërtetën themelore të fesë së krishterë, që Hyji na ka krijuar për pavdekësi, amshim dhe lumturi. Ai këtë na ka mundësuar me mundimin, vdekjen dhe ngjalljen e Jezu Krishtit, nëpërmjet Kishës dhe jetës sakramentale. Vetëm atëherë do të arrihet ajo çka Zoti ka thadruar në zemrat tona, nevojat dhe dëshirat për jetë, për lumturi dhe për dashuri-pavdekësi, sepse përfundimisht do të takohemi me Shëlbuesin tonë dhe “*kur të shfaqet do të bëhemi të ngjashëm me Të, sepse do ta shohim ashtu siç është*” /1Gjn3,2/.



Universi i lirisë në një roman

FAQE 14-15

Shkruan:
Wilson CULAJ

Intervista me don Anton Kçirën

Në shërbim dhe veprim nën “hijen” e Gjergj Kastriotit në Detroit

FAQE 12-13



Takimet e Don Mikelit 2008 – Stubëll

Një manifestim me vlera të pakontestueshme

Proceset nëpër të cilat po kalon Republika e Kosovës, kërkojnë një angazhim të përgjithshëm, korrekt e të qartë. Kërkesa dhe synimi ynë për integritet në strukturat e gjithëmbarshe euro-atlantike, shtrihen në sërë sfidash, të cilat duhet tejkaluar shoqëria jonë. Janë, jo vetëm dëshira dhe kërkesa, por edhe nevojat për integritet, arsyeja, që kësaj radhe në tryezën shkencore të këtij manifestimi për temë bosht të jetë **Kosova përballë sfidave integruese**, temë kjo e shqyrtuar nga aspekti i identitetit kulturor.

Në ligjëratën e tij *Kosova si pjesë integrale e hartës kulturore të Evropës*, Mr. Valton BEQIRI, pasi përmendi kontributin e madh të Justinianit, Konsantinit, Shën Niketës, Jan Kukuzelit e të tjerëve, theksoi se “shqiptarët, kultura shqiptare dhe personalitetet e kësaj kulture gjithnjë kanë qenë të bashkërenditur në të gjitha proceset e globalizimit që gjatë periudhave të ndryshme ka pasur orientime dhe konceptime tjetërfare, por gjithnjë në favor të krijimit të një modeli civilizues, që sot njihet si model eurocentrik, që për shkak të një fondamenti human që ka në thelbin e vet, është model dominues botëror, i shtrirë në të gjitha kontinentet dhe i lakmuar nga të gjitha shtetet dhe kombet e të gjitha kontinenteve. Nga e gjithë kjo ekspozë dhe nga ky ekskurs në të kaluarën, del konkluzioni: kultura ka nevojë për një baras-

peshë ndërmjet konservimit dhe risisë, ka nevojë të vlerësimit aktiv dhe pozitiv të trashëgimisë dhe shndërrimit të saj në një memorie kulturore, si dhe vizionit mbi të ardhmen që duhet të burojë nga sublimimi i vlerave të së kaluarës... Kjo memorie kulturore përbëhet nga objekte arkeologjike, ndërtesa, dorëshkrime, regjistrimi i dokeve dhe zakoneve, artefakteve të natyrës etnografike, etj. që nënkuptohen edhe



Ministër i Kulturës z. Valton Beqiri

me termin trashëgimi kombëtare... Kosova është vend ku referencat kulturore janë të nduarnduarta, ku një objekt kulturor pretendon pronarë të shumë, ku madje ka ndodhur edhe tjetërsimi i ndërgjegjes kulturore...



Fillimi i manifestimit - dëgjimi i himnit kombëtar

Administrata e sotme kulturore, duke ndjekur prirjet integruese në hapësirën unike kulturore evropiane, e ka shtruar si nevojë të domosdoshme përpunimin e një legjislacioni, që do të jetë rregullues i punës, sjelljes dhe përgjegjësisë ndaj kulturës. Ky legjislacion ndjek parimin e unifikimit me standardet evropiane”, theksoi ndër të tjera z. Beqiri.

Arbën Xhaferi, në ligjëratën *Shteti dhe identiteti*, me rëndësi parësore për identitetin kombëtar të shqiptarëve, krahas formulës “3Gj” (gjaku, gjuha dhe gjeografia sipas Françesko Altimari) e sheh edhe historinë e përbashkët, kontinuitetin e tra-

ditës, identifikimin me atë traditë... Ai kundërshton, siç shpreh, skribomanë të ndryshëm, me njohuri minimale për proceset e komb-formimit... të tillë që mohojnë historinë kombëtare, përkatësisht identitetin kombëtar. Pa këtë identitet, sipas Xhaferit, siç dihet humbet arsyeja e formimit të shtetit kombëtar në territoret që cilësohen si habitus jetësor i një populli që përmes shtetit synon ta fitoj statusin e kombit. Çdo popull serioz kultivon rrëfimin për vetveten. Ky rrëfim është fundament i identitetit kombëtar. Pra: Shqiptarët janë popull me prejardhje të verifikuar indo-evropiane, pasardhës të ilirëve; ata e pranuan krishterimin nga apostujt duke dhënë një kontribut të çmuar në pajtimin e paganizmit me krishterimin etj.; shqiptarët janë evropianë, popullatë autoktone dhe kultura

shqiptare në vija të trasha buron nga qytetërimi perëndimor, duke ruajtur të gjitha veçoritë (pavarësisht përkatësive fetare) e tiparet e tyre dalluese nga të tjerët, ndërkohë që vazhdimësi, kultivimi i vlerave të traditës, pastrimi i saj nga huazimet e imponuara, banale janë veprime, jo vetëm legjitime, qytetëruese, por edhe të domosdoshme për ta ruajtur identitetin një popull modern, pa harruar të theksoi se toleranca fetare është faktor përcaktues i identitetit kombëtar të shqiptarëve. Ai, po ashtu, në referimin e tij tërhoqi vëmendjen se Kosova, si noción politik, moral, etnik, historik ka një vull të pashlyeshme shqiptare.

Në këtë truezë, ndërkaq u promovuan edhe tre libra: *Lëvizja kombëtare shqiptare në kazanë* e Gjilanit, e Sadullah Brestovcit, *E folmja e Karadakut* e Mehmet Halimit dhe *Burime dhe dëshmi* e Albert Ramaj.

Në Orën e Madhe Letrare, krijimet e tyre i lexuan 29 poetë. Me çmimin e parë “Agim Ramadani” u shpërblye **Prend Buzhala**, me të dytin **Naime Beqiraj** dhe me të tretin **Rushit Ramabaja**. U nda edhe **Çmimi i kompozitorit Akil Koci**, të cilin për kontributin në kulturë kësaj radhe e mori **Frok Kristaj**.

U shfaq dhe një program i pasur kulturo-argëtues nga ansamblet “Albafolk” (Gjilan), “Kemajl Azizi” (Viti) dhe grupi i SHF “Hasan Prishtina” (Prishtinë). (Sare Gjergji)

Kremtimi i Shën Mhillit kryengjell në famullinë e Doblibares

“Feja është dhuratë e Zotit për besimtarët”

28 shtator 2008. E diela e XXVI gjatë vitit për famullinë e Doblibares ishte një festë e veçantë, kur kjo bashkësi kremtoi festën e Pajtorit Shën Mhillin. Edhe pse ishte ditë pakëz e ftohtë me temperatura të ulëta, megjithatë kjo e kremte mboldhi një numër jashtëzakonisht të madh të besimtarëve nga e tërë Kosova, në veçanti nga rrethi i Gjakovës. Meshën solemne e udhëhoqi ipeshkvi i Kosovës Mons. Dodë Gjergji, i cili u prit në një gëzim dhe nderim të madh prej besimtarëve dhe famullitarit të kësaj famulle don Kolë Thaqi. Ipeshkvi në fjalën e rastit përshëndeti të pranishmit dhe shprehu gëzimin të jetë i pranishëm në mesin e besimtarëve si bari dhe si apostull i Krishtit. Ai theksoi faktin e dhuratës se fesë, të cilën na ka

dhuruar Zoti. E këtë dhuratë ne kemi mundësi ta zbulojmë në mënyra të ndryshme: nëpërmjet Fjalës së Zotit, nëpërmjet zbulimit të Jezu Krishtit, nëpërmjet engjëjve. Prandaj ipeshkvi u fokusua në detyrën, të cilën Zoti ia kishte besuar engjëjve: Gabrielin si dërgues të lajmit të gëzueshëm; Rafaelin si ndihmë e Zotit; dhe Mihaelin (Shën Mhilli) si luftëtar i djallit apo i të keqes. Ashtu ipeshkvi me një dashuri të posaçme dhe fjalë të ëmbla përpiqej t'i vetëdijesojë besimtarët që sikurse engjëjt, ashtu edhe njerëzit Zoti i bashkon dhe u beson detyra të ndryshme. Ashtu sikur engjëjt janë në kujdesin dhe për të mirën tonë, ashtu edhe ne njerëzit duhet të bëhemi kujdestarë e vëllezërve e motrave, me të cilët jetojmë.

Këto fjalë dhe fjalët tjera u pranuan me një gatishmëri të madhe nga besimtarët, të cilët ishin të etshëm për fjalë inkurajuese për të jetuar sa më mirë fenë e tyre, e mu pikërisht nga bari i tyre. Në fund të meshës, të pranishmit i përshëndeti edhe famullitari don Kolë Thaqi, duke u uruar të gjithëve festën dhe duke falënderuar përzemërsisht ipeshkvin që ka pranuar ta gëzojë këtë famullë me praninë e tij. Nuk guxojmë të harrojmë edhe kontributin e korit të famullisë dhe të këshilltarëve, të cilët me angazhimin e tyre e zmadhuan dhe e zbukuruan këtë festë. Pas meshe Famullitari shtrajtoj sofrën vëllazërore për të ftuarit e gjithë ashtu edhe besimtarët hapën dyert të gjithëve për të ndarë sofrën vëllazërore. (Dritapress)



Gjatë kremtimit të meshës në Doblibare


Ushtrimet shpirtërore të meshtarëve

Që nga data 28. IX. 2008 – 30. IX. 2008, 20 meshtarë të Kosovës në krye me ipeshkvin tonë Mons Dodë Gjergji, ishin në ushtrime shpirtërore në Letnicë. Letnica, oaza shpirtërore për të gjithë neve. Moderator i këtyre ushtrimeve ishte meshtari italian don Carlo Fantini, i cili që disa vite me shumë zell shërben në Shqipëri. Edhe pse italian, shumë mirë zotëronte gjuhën tonë të bukur dhe nuk kishte asnjë lloj problemi gjatë ligjërimit. Në një atmosferë vërtet vëllazërore, me ligjëratë të bukura me tematikë biblike, meshtarët u thelluan këtyre ditëve në lutje. Ashtu siç bënte edhe Mësuesi ynë Jezu Krishti, i cili shpesh tërhiqej në vetmi, në vende të pabanuara, dhe tërë natën e kalonte në lutje. Ai shpesh herë i ftonte edhe nxënësit e vet për të shkruar me të. (Shih Mk 6,1).

Kështu edhe në ditën e fillonim në mëngjes në 7 e 30 me lutjet dhe meditimet e mëngjesit. Për të vazhduar pas mëngjesit, edhe me ligjëratën të përgatitur me shumë kujdes dhe pëshpirtëri nga don Carlo, i cili me citate biblike na e ofronte porosinë e qëlluar për ne. Në 11 e 30 kishim meshën e përbashkët me popull që vinin edhe nga famullitë fqinje. Pas dreke kishim pushim deri në 16. Ishte kjo një kohë e volitshme për të shëtitur nëpër atë vend të bukur dhe për të biseduar e dialoguar mes veti për çështjet shpirtërore. Në 16 e 30 kishim ligjëratën e dytë, ndërsa në 18 adhurohim para Shenjtë-rushmit Sakrament, ditën tjetër Udhën e Kryqit, secili meshtar përgatiti nga një shenjë në mënyrë meditative, pastaj kishim mbërmësoren. Pas darkës kishim tryezën e rrumbullakët, diskutim i përbashkët rreth ligjëratave apo për çështjet tjera shpirtërore. Ja

disa nga udhëzimet e don Carlos: Është mirë që gjatë këtyre ditëve të pushojmë shpirtërisht dhe fizikisht. Gjithashtu është mirë që gjatë kësaj periudhe t'i rikujtojmë të mirat që Zoti i ka bërë në jetën tonë dhe nëpërmes nesh të tjerëve. Nëse bashkohemi me Zotin, bashkohemi me të tjerët, sepse Ai është pika e bashkimit. Ai që dëshiron të jetë i përshtirshëm, duhet me Krishtin të largohet nga turma.

Le të mendojemi me Shpirtin Shenjt, t'i zbulojmë fshtësitë dhe planet e Zotit. Ne jemi të dhënë pas të tjerëve. Ne atyre u japim Zotin, bëjmë shumë për ta, por sa mendojmë për vetë, për lidhjen tonë me Zotin? Ushtrimet shpirtërore nënkuptojnë mënyrën për të rërmuar ndërgjegjen dhe për të medituar, siç janë ushtrimet trupore – vrapimi, ecja etj. Ushtrimet shpirtërore na ndihmojnë t'i largojmë prej vetit dobësitë



Don Carlo, udhëheqësi i ushtrimeve shpirtërore

dhe na ndihmojnë në shëlbimin e shpirtit. Ato na ndihmojnë për ta mposhtur vetveten, gëgjësisht të keqen; për të vënë rregull në jetën shpirtërore. Ajo që e kënaq shpirtin nuk është dija, por të ndjesh gjërat në brendi. Shpirti kërkon thellësinë e gjërave, të shijojë miqësinë me Zotin. Pra, jo

shumë gjëra, por thellësinë e tyre.

Ai që bën meditim, është mirë të mos dijë asgjë çka do të bëjë gjatë meditimit. Është me rëndësi të përqendrohemi në atë që bëjmë. Është me rëndësi vetëm ajo që bëjmë në atë moment, pa menduar në gjërat tjera. Armiku në dukjen e të mirës, kërkonte ta largonte Jezusin prej detyrës që ia kishte caktuar Zoti.

Koha e lutjes: Armiku dëshiron në mënyrë të ndryshme të



Pjesëmarrësit në ushtrime shpirtërore

na shkurtojë lutjen. Nuk është me rëndësi sa ne lutemi, por sa jemi të përqendruar në lutje. Armiku gjatë lutjes na afron gjërat të rëndësishme që duhet t'i bëjmë: telefonata e rëndësishme, të shkruajmë diçka të rëndësishme, më vonë mund të harrojë etj. Është me rëndësi ato minuta t'i kushtojmë vetëm Zotit.

Qëndrimi themelor: Është e dobishme të hyjmë në çdo vësh-tirësi me guxim, bujari. Duke ia dhuruar krejtësisht vullnetin dhe lirinë Atij që të na përdor sipas dëshirës së vet. Duhet që

Atij që na ka dhuruar gjithçka, t'i përgjigjemi me bujarinë tonë. Gjithçka kemi dhe jemi, është e Tij. Ai kërkon pjesën më të mirë tonën. Ne frikësohemi prej Tij, andaj edhe bëhemi koprracë ndaj Tij. Zoti dëshiron të na japë, e jo të na marrë. Nuk e kuptojmë që nëse i japim diçka, Ai do të na shpërblejë. Nëse shpirti ynë është mbushur me shumë gjëra, duhet të largojmë diçka për t'i bërë vend Atij. Le të zbulojmë gjatë këtyre

re është vendimi Krishtit të më thërrasë në rrugën e vet: "Qoftë bekuar Zoti që na zgjodhi para krijimit të botës..." (Ef 4).

Jezusi dërgon në botë apostujt, ai i dërgon edhe ata që dëshuan në të, të gjithë. Ai na dërgon, sepse na beson. Ai na dërgon me pushtetin që kishte vetë: *Më është dhënë çdo pushtet...* (Lk 4,5). Djalli ia premtom Krishtit pushtetin e kësaj bote kur e tundon, por Krishti nuk e pranon, sepse e di

ushtrimeve shpirtërore çka duhet të largojmë nga zemrat tona, për t'i bërë vend Krishtit.

T'i zbulojmë rrënjët e thirrjes sonë. Këtë mund ta bëjmë me ndihmën e Fjalës së Hyjit. Aty do ta gjejmë dashurinë që Zoti ka për ne. Thirrja nuk është diçka që lind nga dëshirat e mia. Ajo buron nga zemra dhe lutja e Krishtit. Para se të më thërrasë, unë jam në zemrën dhe mendjen e Tij. Jeta ime është në horizontin e jetës së Tij. Thirrja nuk ndodh rastësisht, por është në dëshirat e Hyjit: *Ju nuk më zgjodhët mua...*, iu thotë Krishti apostujve (Gjn 15,16).

Që unë të shkoj pas Krishtin, është diçka sekondare, prima-

se pushteti i djallit nuk vjen prej Zotit. Pa Zotin nuk kemi pushtet. Çfarë ngushëllimi për ne: *Unë jam me ju, deri në të sosur të botës!* Ne jemi të dërguar për mbarë botën! Ky është misioni i Kishës, unë jam Kishë! Unë jam përgjegjës për ungjillëzimin e botës. Po, unë jam i thirrur, i dërguar prej Zotit për të shërbyer, për të predikuar, për të dëshmuar Zotin në botë, për ta bërë Atë të pranishëm.

Na ndihmoftë Zoti për të jetuar si shërbyes, na bashkoftë Krishti për të vazhduar veprën e Tij, dhe Zonja Cernagore ndër-mjetësiftë gjithmonë para Birit të vet, siç bëri në dasmën e Kanës së Galileës. Amen.

(don Albert Demaj)

Festa e Engjëllit të Rojës në Ferizajt

"Të heqim dorë prej zotave të rrejshëm dhe t'i besojmë Zotit të vërtetë"

02 tetor 2008. Edhe në këtë vit festa e Pajtorit të famullisë së Ferizajt bashkoi një numër të madh meshtarësh, intelektualësh, përfaqësuesish të strukturave të ndryshme politike dhe jo politike dhe shumë e shumë besimtarë e shtetgarë të devotshëm. Gëzim të veçantë solli prania e ipeshkvit të Kosovës mons. Dodë Gjergji, i cili edhe i priu kremtimit eukaristik. Në fjalën e rastit ipeshkvi shprehu së pari falënderimet ndaj Hyjit të Gjithëpushtetshëm për të gjitha të mirat, të cilat Ai ua dhuron çdo ditë besimtarëve të vet. Në veçanti ai falënderoi për engjëjt, të cilët kujdesohen për ne duke na ruajtur prej çdo rreziku e sidomos prej rrezikut më të madh që janë mëkati dhe e keqja. Ipeshkvi më tutje

ilustroi, në kontekstin biblik, me shembuj si nga Besëlidhja e Vjetër po ashtu edhe nga Besëlidhja e Re, të gjitha ato intervenime dhe përkujdesë që Zoti i ka realizuar në historinë e njerëzimit nëpërmjet engjëjve. Ipeshkvi i ftoi besimtarët, që, sikurse në historinë e shëlbimit, ashtu edhe sot, është i gatshëm t'i ndihmojë njeriut. Por njeriu nuk duhet të shkojë dhe të kërkojë ndihmë prej idhujve të ndryshëm. Ipeshkvi i ftoi besimtarët të heqin dorë prej idhujtarisë, zotave të rrejshëm dhe të vihen në shërbim të plotë të Zotit të vërtetë, atij që na ka zbuluar vetë Jezu Krishti. Porosia e ipeshkvit u mirëprit me vullnet të madh nga të pranishmit dhe u ndie nevoja e madhe e fjalëve dhe porosisë se bariut

për të ripërtërirë zemrat dhe shpirtat e besimtarëve. Gëzim i posaçëm ishte edhe për famullitarin e kësaj famullie don Viktor Sopi, i cili në fund të meshës i shprehu falënderimet së pari Zotit, pastaj ipeshkvit që kishte gjetur kohë dhe mundësi për ta drejtuar këtë meshë. Famullitari i falënderoi edhe të pranishmit që kanë ardhur nga viset e ndryshme për t'iu bashkëngjitur sofrës eukaristike, kremtimit dhe përkujtimit të engjëllit të rojës - Pajtorit të kësaj famullie. Duhet veçuar edhe praninë e vikarit gjeneral të ipeshkvisë së Sapës don Carlo Fantini, i cili edhe udhëhoqi ushtrimet shpirtërore të meshtarëve, të mbajtura më parë në Letnicë. Nuk guxojmë të harrojmë një prej koreve më

të mira të Kosovës, që e shtuan gëzimin e kësaj feste me këngët e tyre liturgjike. Ditë e mrekulueshme ishte kjo që përfundoi

me një drekë vëllazërore të cilën e shtrioi, për të ftuarit, famullitari i kësaj famullie don Viktor Sopi. (Dritapress)



Ipeshkvi Dodë Gjergji në praninë e dhuratave

Takimet e “Atë Shtjefën Gjeçovit 2008” në Zym

11 tetor 2008. Në një ditë të bukur të vjeshtës së hershme, ditë e shtunë, në Zym të Hasit u mbajt manifestimi letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit’08”, manifestim tradicional i 37-të me radhë që në gjirin e vet tuboi shumë krijues letrarë, artistë, përfaqësues të jetës politike e publike të Prizrenit, të Kosovës, qytetarë hasjanë, kurbetçarë si dhe pjesëtarë nga Shqipëria, nga Vlorë heroike, Kuksi e të tjerë.

Tematika e manifestimit përbëhej prej shtatë tërësishë: I. Inaugurimi i muzeut “Zymi” në Zym, II. Shënimi i 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit (1908), III. Ora e Anton Pashkut, IV. Ndarja e shpërblimeve, çmimeve e dhuratave, V. Programi kulturor e artistik, VI. Vizita Muzeut dhe VII. Tryeza e përbashkët e drekës.

Pas aktit të hapjes së manifestimit të cilin e bëri Nikollë Kërhanaj, kryetar i klubit letrar “Shtjefën Gjeçovi”, në kuadrin e të cilit bëhet ky organizim, ministri për Kulturë, Rini e Sport,

Valton Beqiri dhe shkrimtari e publicisti Frrok Kristaj bënë prerjen e shiritit dhe përrurimin e muzeut “Zymi” të Zymit, i cili është i vendosur në sallën e madhe, nën platonë e kompleksit memorial “Shtjefën Gjeçovi”. Pas aktit të përrurimit, ministri Valton Beqiri u shpreh: “Ju përgëzoj për tërë punën dhe angazhimet Tuaja që vite me radhë po i bëni në të mirën e kulturës, historisë dhe traditës sonë kombëtare. Ndajhem i privilegjuar që më dhatë rastin ta bëj hapjen e këtij muzeu dhe në emër të Ministrisë për Kulturë ju premtroj se për këto aktivitete të rëndësishme dhe të dobishme do të kenë mirëkuptimin dhe ndihmën tonë edhe në të ardhmen”, duke shtuar se “Puna juaj në vazhdimësi më trimëron dhe më nxitë për një angazhim për investim më të madh në fushën e kulturës”. Në vazhdim, edhe kryetari i Kuvendit Komunal i Prizrenit dr. Rammadan Muja, në paraqitjen e vet u shpreh: “Ju jeni shembull për të mirë duke shtuar se punoni sipas vijës dhe rrugës së trasuar nga At

Shtjefën Gjeçovi që është figurë madhështore e veprimtarisë letrare, fetare e atdhetare.”

Shënimi i datës shumë të rëndësishme – 100-vjetori i Kongresit të Manastirit, u bë me një recital skenik të cilin e përgatiti Frrok Kristaj dhe e interpretuan: Safete Rogova, aktore e Teatrit Kombëtar të Prishtinës, me Sulejman Lokajn, Rustem Latifajn e aktorin Tetaj të Teatrit Profesional të Gjakovës dhe amatorët: Vilson Culaj, Reshit Sahitaj, Arbër Salihu, Albert Marjakaj, Nexhat Çoçaj, Nuri Pervizi, Beqir Letaj e të tjerë po ashtu nga publiku që u inspiruan nga kjo skenë madhështore, si dr. Asqeri Llanaj nga Vlorë e ndonjë tjetër.

Pas një atmosfere të këndshme e imponante, filloi ora letrare “Anton Pashku” ku u paraqitën krijuesit letrarë që i lexuan me punimet e veta, nga Hasi, Prizreni, Prishtina, Kuksi, Pozharani, Mitrovica etj. siç ishin: Qerim Ujkani, Bedri Hysa, Adem Shkreli, Zana Piraj, Kujtim Morina, Nexhat Çoçaj, Rexhep Smailaj, Nuri Pervizi, Sallajdin Krasniqi, Arben Rashkaj, Shani Pnishi, Hatixhe Çollaku, Brikënë Ceraja etj.

Shpërblimi tradicional “At Shtjefën Gjeçovi” iu nda Festivalit Ndërkombëtar të filmit dokumentar dhe të shkurtër “Dokufest”, i cili tash e disa vite mbahet në Prizren të cilin e mori Fisnik Minci. Poashtu u laureuan (shpërblen) me mirënjohje krijuesit hasjanë që kanë botuar dy e më tepër vepra letrare brenda



dy manifestimeve të fundit dhe këta: Besim Muhadri, Sejdi Dida (postmortum), Nikollë Kërhanaj, Ukshin Morina, Frrok Kristaj dhe Rexhep Smailaj.

Këshilli Organizativ i manifestimit ndau çmimin “Unaza e Katit”, punuar nga Rafael Koci, argjendar në Zagreb, me donacion nga kompozitori Akil Koci, që sivjet iu dha aktore më të re të filmit ndërkombëtar – Arta Dobroshiti. Në mungesë të saj çmimin e pranoi i ati i saj Luan Dobroshi.

Ndërkaq, prof.dr. Eçrem Zelnaj, për muzeun e Zymit dhuroi katër fotografi nga kultura jonë historike-kombëtare. Në emër të organizatorit dhuratat i pranoi Nikë Kajtazi, veprimtarë i mirënjohur që punon në SHBA.

Po ashtu, edhe piktori gjilanas Jetullah Haliti-Eti, ia dhuroi veprimtarit Frrok Kristaj një pikturë që simbolizon pagën e cila gjendet edhe te burrshtetasit botëror: Bil Clinton, Zhak Shirak, Papa, Alfred Moisiu etj. Këtyre iu bashkua edhe dr. Asqeri Llanaj, i cili kishte ar-

dhur enkas për këtë manifestim dhe publikisht përshëndeti manifestimin shumë madhështor dhe dhuroi dy organizatorët: Frrok Kristajn dhe Nikollë Kërhanajn me nga një libër-monografi historike “Cakrani në rrjedhat e kohës” (2008). U këmbyen edhe shumë dhuratat në mes të të pranishmëve, por edhe për Muzeun Etno-Historik të Zymit.

Në vazhdim SHKA “Katarina Josipi” u paraqit para publikut me një program kulturo-artistik, me valle popullore.

Në fund, të gjithë të pranishmit vizituan Muzeun e Zymit dhe disa prej tyre i shkruan përshkrimet e veta në librin e posaçëm që është vendosur mbi tavolinën e punës së Shtjefën Gjeçovit dhe dy arkave të tij, ku mbante materialet e veta.

Në numër të pranishmish vizituan kishën “Zoja e Hasit”, shkollën fillore për t’u vendosur në fund në drekën solemne po ashtu me karakter pune për këmbime mendimesh e falenderime rasti. (Nikollë Kërhanaj)



Huorim skenik mbi 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit

E kremtja e Zojës Rruzare në Bistazhin

7 tetor 2008. Ngjashëm me vitet e kaluara, edhe në këtë vit në famullinë e Bistazhinit u kremtua Pajtoja e kësaj kishë “Zoja Rruzare”. Kjo festë filloi me paraqitjen e treditëshit të shenjtë për nevojat dhe kërkesat e shumta të besimtarëve e sidomos për paqe në familje dhe në shoqëri. Meshët gjatë këtij treditëshi i udhëhoqën meshtarët: don Kolë Thaqi, don Kelmend Spaqi dhe dr. don Lush Gjergji, të cilët i porositën besimtarët tanë mbi rëndësinë e Rruzares si nevojë e domosdoshme për familjet e krishtera.

Po ashtu në ditën e së kremtes së Zojës Rruzare, meshën në ora 9 e celebroi don Franë Kola, delegat i përgjithshëm i Administratës Apostolike të Prizrenit dhe famullitar në famullinë e Velezhës.

Mesha kryesore filloi në ora 11, e udhëhequr nga don David Gjuga, biri i kësaj famulle, në bashkëmesim me meshtarë të tjerë të vendit tonë. Don Davidi është drejtor i radio Vatikani në seksionin i gjuhës shqipe dhe është famullitar në një prej famullive të Romës që i është kushtuar gjithashtu Zojës së Bekuar.

Don Davidi gjatë homelisë së

tij pasqyroi rëndësinë e kësaj dite të madhe duke prekur tema të ndryshme si: themelimin e Rruzares, ndërmjetësinë dhe rolin që Zoja Rruzare e ka luajtur gjatë historisë, bamirësinë e vetë Zojës, Nënës së Hyjit, me anë të së cilës besimtari mund të jetë në mënyrë të vazhdueshme në shoqëri me Zotin duke e identifikuar jetën e tij me vetë HYJIN përmes Rruzares dhe me anë të ndërmjetësisë së saj.

Duke kujtuar se ishte festa e parë, e cila po kremtohej në Kosovën e pavarur, Don Davidi luti

dhe porositi personalitetet e larta shtetërore për punë dhe angazhim më të madh, duke dashur të theksojë dhe të sinjalizojë se Kosova ka shumë punë për të bërë drejt proceseve të saj zhvillimore në sfera të ndryshme të jetës shoqërore dhe institucionale, drejt kultivimit të vlerave jetike dhe frymëzimit të tyre në fe, shpresë dhe dashuri me Zotin dhe me të afërmin.

Po ashtu, duke i pasur parasysh rrethanat aktuale në vend dhe në famullinë tonë, ai porositi besimtarët duke e saktësuar kohën e kthi-

mit kah Zoja Rruzare me të cilën besimtarët kanë për t’i shërbyer Zotit dhe Shoqërisë në vend, pra Zoja do të jetë një ndihmë e kësaj shoqërie drejt shpëtimit nga e keqja në sajë të vlerave të mirëfillta shpirtërore. Pra, u lut për bekim në këtë famulli, për mbare vendin tonë dhe mbare botën. Ajo çka e bënte të veçantë këtë ditë, ishte mesazhi apo urimi i dërguar nga Papa Benedikti XVI, dërguar famullitarit Don Rrokut dhe besimtarëve të kësaj famulle, duke na përgëzuar për festën dhe njëherësh

duke na ndarë bekim për vendin tonë. Ai solli edhe dy dhuratat kësaj famulle, Figurën e Zojës së Bekuar dhe atë të Nënës Terezë, bijës sonë më të mirë shqiptare dhe të mbarë botës. Në fund, don Davidi dhe të pranishmit i përshëndeti famullitarin i kësaj famulle don Rrok Gjollleshaj dhe i falënderoi të gjithë për pjesëmarrje. Pas meshe, famullitari dhe shumë e shumë familje, në shenjë bujarie dhe mikpritjeje, shtruan sofrat vëllazërore për të ftuarit, miqtë dhe dashamirët e vet. (Pashk Mamrecqaj)



Kremtimi i festës së Zojës Rruzare

Faleminderit!

Redaksia i shpreh falënderimet e përzemërta don Fatmir Koliqit për punën e kryer me zell të madh si redaktor i revistës së ipeshkvisë së Kosovës “Drita” dhe njëherit i uron atij suksese në fillimin e studimeve postdiplomike në Romë.

Sinodi i Ipeshkvinjve

“Fjala e Zotit në jetën dhe në misionin e Kishës”

Në krahasim me Sinodin e mbajtur tri vjet më parë, tema e Eukaristisë, tani gjatë muajit tetor, në Vatikan është mbajtur Sinodi i Ipeshkvijve mbi Fjalën e Zotit, burimi tjetër jetik i Kishës, që është gjithashtu në qendër të vëmendjes si ngjarje mjaft e rëndësishme e mbarë Kishës universale. Kushtetuta dogmatike mbi Zbuluesin Hyjnorë “Dei Verbum”, që është një nga dokumentet më të bukura dhe më të rëndësishme të Koncilit II të Vatikanit, por pas dyzet vjetësh ndjehet rishtas nevojja të flitet për të. Detyrat e mëdha të Kishës në botën bashkëkohore – ndërmjet tjerash ungjillëzimin dhe ekumenizmin – përqendrohen mbi Fjalën e Zotit e njëkohësisht përligjen e mbështeten prej saj. Kështu e sintetizoi edhe Papa Benedikti XVI sivjet kuptimin e Asamblesë së Sinodit të Ipeshkvijve. Mbi të gjitha, sep-

se çdo i krishterë, por edhe çdo bashkësi, duhet t’ia vërë vazhdimisht veshin Fjalës së Zotit, pikë e vërtetë mbështetjeje për udhën e tij e për kthimin e tij të përditshëm. E mbetet akoma shumë për të bërë e për të përhapur familjaritetin me Shkrimin e Shenjtë, përdorimin e tij nga populli i krishterë, leximin dhe meditimin e tij të vazhdueshëm, normë për t’u lutur, duke u nisur pikërisht nga Shkrimi i Shenjtë. Prandaj, për ta lexuar Biblën, shkenca është themelore, por jo e mjaftueshme, ndihmon të kuptojmë se Shkrimet e Shenjta biblike nuk janë mitologji, por histori e vërtetë. Mirëpo shkenca mund edhe të rrezikojë dhe ta konsiderojë Biblën si një tekst që i përket së kaluarës. Prandaj metoda historiko-kritike, duhet kompletuar me leximin e Biblës me fe, në gjirin e bashkësisë, sipas traditës, magjisterit e etërve

të Kishës, na kujton gjithashtu Papa Ratzinger. E kjo, edhe pse Shkrimi i Shenjtë është baza e çdo kumti të krishterë, edhe në botën moderne e në dialogun me kulturat e saj. Në mënyrë të posaçme Ipeshkvijtë kujtuan se dialogu ekumenik nuk mund të bazohet mbi ‘mjete strategjike’, por mbi kumtimin e mbi kthimin e përbashkët, në dritën e Fjalës së Zotit, e se edhe dialogu ndërfeetar ka në qendër të vëmendjes leximin e Biblës. Ndoshta në mjetet shekullore të komunikimit jo të gjithë do ta kuptojnë këtë, por mbarë Kisha përgatitet të jetojë një çast tepër të thellë reflektimi e lutjeje: jemi në zemër të identitetit të saj, në burimin e gjallërisë së saj, nën veprimin e Shpirtit të Hyjit. Ndryshe nga Sinodet e mëparshëm, sivjet nën shenjë e ekumenizmit morën fjalën përfaqësuesit e Kishës ortodokse greke,

Arkimandriti Ignatios Sotiriadis dhe Frère Alois, prior i Bashkësisë ekumenike të Taize-s. I pari kërkoi që të krishterët të japin një dëshmi të përbashkët feje, një shenjë të dukshme bashkimi, i dyti uroi që të bëhen hapa të reja drejt ekumenizmit shpirtëror. Arkimandriti theksoi nevojën e respektimit të çdo njeriu, pavarësisht nga raca e feja, e Frère Alois kërkoi vëmendje më të madhe ndaj etjes për fe të rinisë. Jo rrallëherë të rinjtë ishin në qendër të vëmendjes gjatë diskutimeve të etërve sinodale, që përfaqësojnë një nga sfidat më të mëdha të shpalljes së Fjalës së Zotit dhe që kanë nevojë më tepër për dëshmitarë se sa për mësues. Detyrë e Kishës është që t’u afrohet këtyre të rinjve, për t’u mësuar sesi ta përballojnë atë që ndodh përrëth e brenda tyre, duke i ndihmuar t’i rilexojnë ngjarjet në dritën e Fjalës së Zotit. Ndërkohë Kardinali Tarçizio Bertone, sekretar i shtetit të Vatikanit, theksoi se edukatorët e tyre të fesë duhet t’i ndihmojnë të vënë në jetë Fjalën e Zotit, duke e dëshmuar ata vetë të parët. Të rinjtë e meditojnë pak Biblën, por janë të etur për dëshminë e vërtetë të Ungjillit. Nga shumë persona u theksua nevojja e formimit të katekistëve dhe e rëndësisë së rolit të tyre, që brezat e rinj ta kuptojnë që Zoti e lumturia nuk janë dy gjëra të ndara.

Ndër temat e tjera të rëndësishme ishin edhe fëmijët. Për është propozuar një takim botëror, që edhe më të vegjëlvë t’u arrijë Fjala e Zotit të jetës. Shkurtime të këto janë vetëm disa nga propozimet e bëra nga Sinodi i Ipeshkvijve që kështillon të vështrohet me kujdes frytë që sjell Fjala Hyjnore të çdo njeri: - në raste konfliktesh etnike dhe tensionesh ndërfetare

kërkohet impenjimi i katolikëve në ndërtimin e urave të dialogut për të ndërtuar një shoqëri më të harmonishme; Shkrimi i Shenjtë të ketë një vend të dukshëm nëpër Kisha dhe që roli i lexuesve të studiohet dhe të thellohet, pse jo edhe duke marrë parasysh teknikat e reja të komunikimit dhe përdorimin e madrave të zërit; - një rëndësi të madhe i jepet në dokumentet homelive që grishin për mision, homeli këto të përgatitura me uratë dhe të ushqyera nga doktrina dhe është sugjeruar themelimi i një drejtorie për homelitë; gjithashtu një vend të dukshëm zë edhe “Lectio Divina”, që duhet nxitur nëpër famulli, nëpër familje, nëpër lëvizjet e ndryshme kishare për formimin e meshtarëve të ardhshëm e të katekizmit. Gjithashtu ia vlen të theksohet se edhe Kisha ndër shqiptarë kishte përfaqësuesit e saj në Asamblesë kishare: Imzot Zef Gashi, kryepeshkvë i Tivarit; dhe Imzot Lucjan Avgustini, ipeshkvë i Sapës. Në fakt ky është një Sinod që fton të gjithë besimtarët të marrin në dorë Fjalën e Zotit e të pyesin se ç’do të thotë kjo për popullin e krishterë. Edhe Kisha Katolike në Shqipëri, Kosovë dhe Mal Zi jeton duke u nisur nga Fjala e Zotit, të cilën e mediton në çdo meshë shenjte, e cila udhëheq çdo besimtarë të tij dhe e çon në zemër të Eukaristisë. Unë besoj e shpresoj që ky Sinod për mbarë popullin tonë do të jetë fillimi i një kohe të re, që besimtarët tanë të lejojnë të rritet brenda tyre Fjala e Zotit, por edhe që Kisha ta përforojë thirrjen e saj misionare. Duhet të kemi besim në Zotin që na flet, sepse është feja në Jezusin, meqë Fjala e Zotit është fjala e Jezusit dhe takimi me Të. (Don Robert JAKA)



Nuk ka të ndalur dhuna kundër të krishterëve në Indi

Nuk ndalen sulmet dhe dhuna kundër të krishterëve në Indi. Në shtetin e Orisë, ku që prej disa javësh po zbatohet një pogrom kundër katolikëve dhe protestantëve, janë vrarë edhe dy persona të tjerë. Gjendja është keqësuar edhe në shtete të tjera si Çatisgari, Madia Pradesh, Karnataka e Kerala, ku gjatë ditëve të kaluara, fundamentalistët hindu kanë goditur disa kisha të rëgoës. Murgeshat e meshtarët janë detyruar të fshehin identitetin e tyre për t’u shpëtuar persekutimeve dhe kthimit me forcë në hinduizëm. Dje, kisha e Emrit të Shenjtë të Jezusit së bashku me dy të tjera në Bangalore, u sulmuan nga vandalët.

Sipas vëzhguesve, këto organizata ekstremiste kanë si pikë referimi partinë hinduiste Baratiya Janata Parti. Vala e dhunës filloi menjëherë pas takimit kombëtar të kësaj partie në Bangalore, ku u përvijua strategjia për zgjedhjet e ardhshme kombëtare, që do të mbahen në marsin e ardhshëm.

Këtyre ditëve, kryepeshkvi i Bangalores imzot Bernard Moras, u ankua publikisht para autoriteteve politike vendase, në praninë e gazetarëve. Shteti indian që ka premtuar t’i mbrojë të krishterët, ka arrestuar deri tani 70 anëtarë të grupit radikal “Bajrang Dal”, duke përfshirë edhe kryetarin Mahendra Ku-

mar, por kjo nuk e ka ndalur dhunën. Të krishterët, katolikë e protestantë, përbëjnë 2.5% të popullsisë një miliardëshe indiane, ndërsa rreth 80% e indianëve janë hinduistë.

Këtyre ditëve u vra edhe një meshtar katolik në një kuvend në veri të vendit, 400 km nga Nju Delhi. Policia nuk përjashton mundësinë e përpjekjes për rrëmbimin e tij, që ka përfunduar tragjikisht. Kuvendi është plaçkitur nga keqpërsuesit dhe është gjetur edhe trupi pajetë i një gruaje me të meta mendore.

Ndërkaq, kryepeshkvi i kryeqytetit të shtetit të Orisë ka marrë një letër me kërcëni-

me nga ana e fundamentalistëve hindu. “Gjak për gjak, vdekje për vdekje” shkruhet në të, duke e detyruar imzot Çinat të mos

kthehet në selinë kryepeshkvnore nga Kerala, ku ndodhet që nga fillimi i dhunës, më 24 gusht. (Dritapress)



Hyji krijues dhe zbulimet e reja shkencore

■ SHKRUAN:
Don Pal TUNA

Hyji është krijues: “*krijoi qiellin e tokën*” (Zan 1,1), do me thënë krijoi nga asgjëja të gjitha dhe e dhuroi jetën. Kjo e vërtetë na dhurohet nga zbulimi i traditës hebraike-krishtere. Feja e krishterë gjithmonë beson në Hyjin Krijues, Shpëtimtar, dhe sheh në Hyjin fillimin dhe mbarimin e tërë Krijimit. Mileniumet e pa eksploruara të para-historisë se universit dhe milienët e historisë se njerëzimit, janë faqet e shkruara nga Hyji Krijues dhe përmbajnë sekrete dhe mistere që njeriu duhet t’i përthellojë.

Izraeli, me daljen nga Egjipti, në tërë historinë e tij e ka sprovuar se si Hyji i mban në duart e veta njeriun, popujt dhe ndodhitë. Në Të mund të kesh besimin absolut. Është i plotfuqishëm dhe mund t’i mbajë premtimet. Është Zotëria i pakundërshtuar i historisë dhe i universit. Është Zotëria, sepse është Krijuesi dhe gjithçka varet nga Ai: “*Sepe ai foli – gjithçka u bë, Ai urdhëroi – gjithçka u përfutua*” (Ps 33,9). Bota ekziston, sepse Hyji e dëshiroi dhe është shprehja më e lartë e dashurisë. Kjo është porosia që Bibla na e porosit: “*Në fillim Hyji krijoi qiellin e tokën*” (Zan 1,1). Fillimi i botës shkon nga miliona vite, në pafundësi të heshtjes, diçka e re prapë ndriçon, diçka që më parë nuk ekzistonte dhe nga një moment fillon të ekzistojë, të lëvizë, të rritet dhe të marrë jetë. I tërë universi është i mbështjellë nga drita e Hyjit sikur një fëmijë në kraharorin e nënës: kjo qartësi nxit në zemrën e besimtarit një fe të pakushtëzuar në dashurinë e Hyjit.

Njohja e çdo krijese vjen nga Hyji dhe banon në Hyjin, nxit një respekt për tërë krijimin, dhe ngjall një përshtirësi “ekologjike” të bërë nga kujdesi, nga dhembshuria për tërë krijimin. Hyji Trini është zanafilla dhe fillimi, “Alfa” e krijimit, burimi dhe vendlindja e tërë jetës. Prandaj këtu na thërret edhe Besojmja ku dëshmojmë që mbarë krijimi zë fill nga vepra e Atit: “*Besoj në një Hyj të vetëm, Atin e gjithëpushtetshëm, Krijuesin e qiellit dhe tokës, të gjitha sendeve që shihen e që nuk shihen*.” Ndërsa në përmjet Birit dëshmojmë: “*Ai është shëmbëllesa e Hyjit të papashëm, i Parëlinduri – para çdo krijese. Sepse në Të u krijua çdo gjë në qiell e në dhe, çka shihet e çka nuk shihet: qoftë Fronet, qoftë Zotërimet, qoftë Princi-*



patat, qoftë Pushtetet – gjithçka u krijua nëpër Të dhe për Të. Ai është para çdo gjëje dhe çdo gjë qëndron në Të.” (Kol 1,16). Raporti mes vetëve Hyjnore është raport dashurie i projektuar dhe që e prek tërë universin. Në Shpirtin Shenjtë dëshmojmë që është shprehja e dashurisë mes Atit dhe Birit, bashkimi i gjithë krijimit me Krijuesin, e siguron unitetin e krijimit me Hyjin, garanton autonominë e krijesave në liri, dhe e përcjell çdo ripërtëritje të krijimit dhe të njeriut. “*terri e mbulonte humnerën dhe fryma e Hyjit endej përmbi ujëra.*” (Zan 1,2), “*Po e dërgove frymën (Shpirtin) tënd, përsëri e përtërin dhe e rinon fytyrën e dheut.*” (Ps 104,30). Gjithçka u krijua nga Ati nëpërmjet Birit e në Shpirtin e Shenjtë.

“*Po të përbetoj, biro, shikoi qiellin e tokën e gjithçka është në ta e dije se Hyji i ka krijuar nga asgjëja.*” (2Mak 7,28). Është feja të cilën nëna e Makabenjve ua transmeton fëmijëve. Gjithëpushtësia krijuese nuk mund të matet me parametrat e njohurive njerëzore. Bota, ashtu si e krijoi Hyji, është e bukur. Në këtë botë gjinia njerëzore e ka vendin e pri-

vileguar, sepse është shëmbëllesa më e afërt e Hyjit, dhe këtu qëndron i tërë dinjteti i njeriut. Kur shën Gjoni shkruan: “*Në fillim ishte Fjala... Prej Saj u bë çdo gjë e pa Të nuk u bë asgjë.*” (Gjn 1,1,3), na dëfton si Fjala participant në krijim. Hyji At, atëherë kur projektton, krijon dhe realizon dhe e shpreh nëpërmjet Fjalës tërë kreativitetin: “*Sepse në Të u krijua çdo gjë në qiell e në dhe, çka shihet e çka nuk shihet.*” (Kol 1,16). Ai vazhdon t’i dhurojë botës dritë e jetë: “*E çdo gjë që u bë, e pati në Të jetën e Jeta është drita e njerëzore; e Drita shndriti në errësirë e errësira nuk e pushtoi.*” (Gjn 1,3-5). Fjala e bërë njeri, Biri i Hyjit, i mishëruar për shpëtimin e ndërzimit dhe mbarë krijimit e drejton drejt plotësismit dhe shpëtimin mbarë krijimin, realizon në vetvete: “*kur të plotësohej koha: d. m. th. të vërë çdo gjë nën kryesinë e Krishtit, të gjitha qeniet që janë në qiell e në tokë.*” (Ef 1,10). Edhe veprimi i Shpirtit të Shenjtë është aktual dhe shtrihet në çdo krijesë: “*Po e dërgove frymën (Shpirtin) tënd, përsëri përtërihen dhe e rinon fytyrën e dheut.*” (Ps 104,30), Shpirti “*Era frymë në drejtimin që do*” (Gjn 3,8), Shpirti i Shenjtë është

Dashuri, në përmjet Shpirtit, kur e shikojmë jetën është e mundur të themi aty ku është qenia është dashuria, dhe tërë ekzistenca ka qenë dhe do të jetë për amshim dashuri.

Krijesat e kanë dhuratën për të qenë e për t’u zhvilluar, Hyji Krijues jep forcën që gjërat të zhvillohen dhe transformohen në ndërvaresi. Bibla prezanton krijimin në dy tregime që janë reflektim e jo një faqe e historisë dhe e shkencës. Dy tregimet e lindura në ambiente të ndryshme në Lindjen e afërt, janë të ndryshme por domethënia është kjo: bota dhe njeriu varen nga Hyji, krijesat janë të mira e dinjteti i njeriut është aspekti më i spikatshëm. Në pjesën e dytë të tregimit të Biblës (Zan 2,5), në realitet më i vjetri tregim përmban përshkrimin më të bukur mbi krijimin; bota lulëzon në mesin e një shkretëtire sikur një oazë, me përplot zhvillim të jetës dhe e ujitur me lumenj të pastër sikur një kopsht i besuar në duart dhe nën kujdesin e njeriut. Njeriu është i bërë nga toka, por Hyji Krijues i dhuron hukamën e jetës (Zan 2,7), që e bën subjekt shpirtëror, i Zotit, i aftë të dialo-

gojë me të. Burri dhe gruaja janë krijesa të njëjta e të barabarta. Për këtë e kanë edhe të njëjtin dinjtet, janë krijuar të jetojnë së bashku, por jo të ndarë, janë të nevojshëm njëri për tjetrin, jo për mbijetesën, por për të qenë autentik vetvetja, të ndryshëm në gjini, edhe në mënyrën e perceptimit të gjërave dhe jetës dhe të raportit me krijimin. Evolucionin nuk i jep arsye fillimit të ekzistencës njerëzore. Në krijimin e njeriut Hyji e thërret në bashkim me vetveten: “*Hyji krijoi njeriun në përngjasimin e vet, e krijoi në përngjasimin e Hyjit; i krijoi mashkull e femër.*” (Zan 1,27). Për faktin se njeriu është në përngjasimin e Hyjit, është një karakteristikë që e ndan nga krijesat e tjera dhe e veçon. Burri dhe gruaja janë fryt i dashurisë, sepse e ruajnë frymën e Zotit si Tabernakulli më i lartë i krijimit, dhe Hyji i caktoi bashkëpunëtorë dhe dominues të mbarë botës, për zhvillimin, shfrytëzimin dhe ruajtjen e tokës (Zan 1,28).

Prandaj nuk është fati anonim dhe i verbër që e mban universin dhe që është në përkujdesjen e njerëzimit. Por njeriu nëpërmjet mëkatit e humbi Besëlidhjen e Zotit, iku nga kujdesi i Krijuesit, njeriu nuk beson në Hyjin dhe bie në dinakërinë e gjarprit, imazh i idolarisë së djallit, refuzon ta njohë Hyjin si Zotërinë e jetës së tij. E merr dhe ushqehet me frytën e pemës së dijes të së mirës dhe të së keqes, njeriu bëhet ligi i vetvetes, dëshiron të eksperimentojë gjithçka dhe të vendosë se çka është e keqe dhe e mirë, dëshiron të jetë Zot. Por njeriu gjendet i zhveshur, dhe vetëm, në ikje, në një tokë të bërë armiqësore, i përkulur nga turpi, i kërcënuar nga vdekja, i paafte të kontrollojë instinktet e veta. Refuzimi i Hyjit sjell në vete ndarjen edhe në gjininë njerëzore. Harmonia me Hyjin dhe me të tjerët, ka humbur nëpërmjet mëkatit dhe kthimi në kopshtin e jetës është i mbyllur: “*i vendosi kerubinët e shpatën flakëruese e vringëluese për ta ruajtur shtegun e pemës së jetës.*” (Zan 3). Njeriu fillon të jetë i tërhequr nga logjika e mëkatit. E keqja e kishte kapluar botën në gjitha anët: “*Toka ishte prishur para syve të Hyjit dhe ishte mbushur me dhunë.*” (Zan 6,11). Shoqëria njerëzore sjell dërrmim, nuk mjafton “teknika” për ta sjellë në përfundim Kullën e Babelit (Zan 11,1-9).

Mekati ka sjellë dëme e fatkeqësi dhe këto së pari duken në

jetë, në natyrë e në familje. E tërë kjo largësi e shkaktuar nëpërmjet mëkatit, kuptohet më së miri në Jezu Krishtin, i cili u mishërua për lirinë e njeriut, për zgjimin e njeriut dhe ngritjen e tij dhe, nëpërmjet kësaj ngritje, është edhe çmimi i madh, të cilin e paguan me vdekje Biri i Hyjit. Njeriu i lënë në vetvete është i thyeshëm, merr tiparet e kundërshtarit të Hyjit që është djalli dhe e dëmtun të bukurën, të mirën. Komunikimi i të mirës është i infektuar dhe i sforcuar nga e keqja, e cila rritet me ndodhitë e përditshmërisë në njeriun, e deformon shoqërinë njerëzore me një mentalitet dhe me struktura që ndikojnë edhe në vendimet personale. Kështu zhvillohet një histori e tjetërsuar nga Hyji; një histori që nuk bashkëpunon me komunikimin e jetës hyjnore, por e pengon dhe e bllokun atë.

Tregimi biblik mbi mëkatin e parë të Adamit dhe Evës, e përmban edhe premtimin e shpëtimit (Zan 3,15-22). Tregimi i përmbajtjes, një dënim për njerëzimin përfundon me një besëlidhje mes Hyjit dhe Noehit që e ka simbolin e ylberit, urë-lidhëse e dritës mes qiellit e tokës (Zan 9,8-17). Pasi populli të jetë i përgatitur nga Fjala dhe Ligji: "Por, kur erdhi koha e caktuar" (Gal 4,4), Hyji nëpërmjet Birit të tij Jezu Krishtit, e dëshmoi në plotësi dashurinë për çdo njeri. Pajtimi me Hyjin Jezus nuk imponohet nga jashtë, por zhvillohet duke u nisur nga zemra e njeriut. Bota e krijuar nëpërmjet Birit rritet dhe plotësohet nëpërmjet Tij. Të pohosh që Hyji është Krishti i universit, domethënë që bota është menduar nga dikush. Nëna e Makabenjve pohon: "Po të përbejoj, biro, shikoj qiellin e tokën e gjithëka është në ta e dije se Hyji i ka krijuar nga asgjëja." (2Mak 7,28). Krijimi stabilizon edhe një raport familjar, nëpërmjet krijimit fillon besëlidhja mes Hyjit dhe njeriut që e gjë në plotësinë në Jezusin, Emanuelin – Hyji më në: "njeriu është më i madh kur në të zhvillohet kapaciteti i tij të vihet në dëgjues ndaj porositë se Krijimit", thotë Benedikti XVI. Kemi edhe të tillë që nuk e përjashtojnë Hyjin nga krijimi, por flet sikur për "diçka" që i ka dhënë shkak për ta vënë në veprim, për t'u tërhequr pastaj në mister duke i lënë që gjërat të shkojnë sipas rastësisë. Disa të tjerë pranojnë që "Hyji" e ka provokuar "shpërthimin e madh" të Big-Bangut, nga i cili u arrit formimi i universit, i cili është zhvilluar gradualisht sipas ligjeve dhe dinamizmave, sipas të cilave Hyji judeo-krishterë-islam nuk ka të bëjë asgjë me të. Të tjerët ende e vendosin "evolucionizmin" doktrinë biblike mbi krijimin, duke injoruar në realitet se feja e krishterë dhe evolucionizmi nuk janë në kontrast. Kultura jonë e ka degraduar me shkronjë të vogël fillimin e falës *hyji* dhe e ka ngritur me shkronjë të madhe fjalët: Shkencë, Raca, Kombe,

Drejtësi Kushtetuese, Diktaturë, Revolucion, Kulturë, Shtet...; sa sakrificat të mëdha qëndrojnë prapa këtyre fjalëve – fetish që e kanë trashëguar shkronjën e madhe të Hyjit: "gjithëka vjen prej Hyjit." (1Kor 11,12). "për ne s'ka veç një Hyj, Atin, prej të cilit është krijuar gjithëka e të cilit në i përkasim; dhe një Zot të vetëm Jezu Krishtin, nëpër të cilin është gjithëka e në jemi nëpër të." (1Kor 8,6). Njerëzimi dhe natyra janë krijesa të Hyjit, dhe kjo gjithëpushtetësi e tij duhet t'i njihet. Sepse Hyji nuk e përkufizon lirinë e njeriut, përkundrazi ai e orienton njeriun dhe ia precizon dinjitetin e tij, gjithëka nën zotimin e tij që ai t'i thërrasë gjërat me emër dhe e cakton si *dominus* që të kujdeset për të. Por me progresin shkencor, teknologjik, të inxhinierisë gjenetike dhe me teknologjitë e

dhe të transformojë, është në një farë mënyre në gjendje të krijojë një botë në mënyrën e vet, harron që kjo zhvillohet gjithmonë nga dhurata e zanafillës së dhuruar të gjërave nga ana e Hyjit...; mendon se mund të rregullojë në mënyrë arbitrare token, duke e shfrytëzuar pa rezervë sipas dëshirave të tij vetjake...; përkundrazi duhet të luajë rolin e bashkëpunëtorit të Hyjit në zhvillimin e krijimit, njeriu dëshiron të zërë vendin e Hyjit e kështu përfundon të provokojë rebelimin e natyrës, se sa të tiranizojë dhe ta dominojë nga ai" (Cent. Annus, n.37). Krijimi është shenjë e Fuqisë së Hyjit, është një vepër dashurie ndaj njeriut, është një rrugë që na krijon te Ai. "Për ty tha zemra ime: 'Kërkoni fytyrën time!' Fytyrën tënde, o Zot, do ta kërkoj. Mos e fsheh

totalisht njëri-tjetrit, dashurohen, adhurohen në mënyrë të përsosur hyjnore, të pambarim, në mënyrë që jeta e dashurisë jetë çdo herë vazhdimësi krijuese. Kjo është natyra e Hyjit: dashuri që dashuron, që e dëshiron të mirën e njeriut, që dhurohet vazhdimisht. Nga kjo dashuri lind krijimi, Hyji ka krijuar sepse e ka dashur në mënyrë të lirë të krijojë universin. Tërë krijimi është dëshmia e Hyjit, është një himn i lavdisë së tij. Misteri i krijimit, zhvillimet në histori e në botë, janë fillimi i pyetjeve për njeriun; por në kërkimin gjithnjë e më shkencor të kohës që duhet të plotësohet, duhet të kemi një qëndrim fetar që e pranon qëllimin dhe hukamën transcendentale. Feja në Hyjin Atë krijues, në Birin shpërblimtar e shëlbues e në Shpirtin shenjtëruës, nuk

rrur Zotin në ndihmë, duke i besuar Atij, duke u mbështetur në Të. Nuk është kjo një shenjë? A është e mundshme që një gjë e tillë t'i drejtohet një Qielli të zbrazët?

Gjeneratat e reja rriten nën presionin e teknikës edhe të mrekullive të teknikës, jetojnë në qytete të ndërtuara dhe që janë vetë çimento, janë në kontakt të vazhdueshëm me çdo lloj makinë, luajnë me jetë të sofistikua elektronike dhe e shikojnë natyrën me mentalitet shfrytëzimi të pakontrolluar. Transformimet e reja të punës si në atë bujqësore, fabrikat, kuzhina apo zyrat, janë të përbëra nga mekanika dhe informatika dhe të cilat propozojnë gjithmonë pyetje të reja.

Pra zbulimi i Zotit është gradual dhe progresiv. Teoria e Einsteinit, edhe pse është e vlefshme, prapë se prapë nuk mund t'i shpjegohet një fëmijë të mos-hës 6-vjeçar: mendja e tij është ende e "vogël"; pra Zoti nuk i zbulohet njeriut apo pyetjeve shkencore nëse njeriu nuk është i gatshëm dhe në gjendje ta pranojë këtë dëshmi. Hyji e edukon njeriun, i ndihmon t'i hapet misterit, i zbulohet gradualisht dhe e pret një përgjigje nga njeriu.

E vërteta, bukuria, mirësia e krijesave, na dërgojnë në përsosmërinë e pambarim, pra në Hyjin. Komplexet e strukturave të gjalla na bëjnë të reflektojmë në një inteligjencë, e cila krijon. Misteri i njeriut, inteligjent dhe të lirë, që rishfaqet në çdo fëmijë që lind, na dërgon në një inteligjencë që është edhe më e lartë, më e madhe. Gurët në vetvete nuk e bëjnë një katedrale; kanë nevojë për një projekt dhe për një arkitekt. Elektronet, protonet, neutronet nuk organizohen nga vetvetja; një mizë e vogël është më komplekse se një anije kozmike, sepse mbi të gjitha është e gjallë; dhe asnjë shkencëtar nuk është i aftë të prodhojë një gjë të tillë – të gjallë. Miliarda qelizat të trupit të njeriut janë të lidhura mes veti dhe të varura mes tyre: çdo njëra është më shumë se një fabrikë e automatizuar; por mbi të gjitha njeriu është krijesë e gjallë, inteligjente dhe e lirë. A munden elementet e zanafillës të ngrihen nga vetja në një përsosmëri të tillë?

Kjo botë i shërben njeriut për dy gjëra: për ta ushqyer e për ta mësuar.

Tërë universi është me gjëra e porosi, të cilat na thërrasin. Të mundahe mi të shkojmë në shkollën e krijesit, në shkollën e ujit i cili nuk ndalet kurrë, në shkollën e një lule erëmirë e që lëshon në të njëjtën kohë edhe qetësi shpirtërore, të shkojmë në shkollën e rrënjëve më të thella në terrin e tokës që presin e besojnë në ujin e diellit, në shkollën e një fije bari të shkelur, e cila fije ngritet dhe e shikon prapë qiellin me të njëjtën krenari, apo në shkollën e një pike uji, e cila i përmbledh gjitha ngjyrat e ylberit, të mësojmë nga mbarë krijimi fillimet e Krijesit.



“Hyji e edukon njeriun, i ndihmon t'i hapet misterit, i zbulohet gradualisht dhe e pret një përgjigje nga njeriu.”

sofistikuara ambientale, shpesh lëvizin, hulumtojnë, dëmtojnë pa e pasur parasysh Hyjin Krijues dhe të cilët nuk përkujdesen dhe as nuk e mbrojnë kopshtin në të cilin njeriu lind, rritet, zhvillohet dhe ushqehet. Degradimi i natyrës nga ana e njeriut, holokausti ambiental, janë pasojat e një keqpërdorimi të pakontrolluar të resurseve natyrore, të cilat janë bërë kërcënim mbi ekzistencën e njeriut: "Në burimin e çmendur të shkatërrimit të ambientit natyror është një gabim antropologjik..." - thotë Papa. - Njeriu që zbulon në vetvete kapacitetin të bëjë zbulime dhe hulumtime

fytyrën tënde prej meje". (Ps 26, 8-9). Por për ta njohur ende më mirë Hyjin duhet ta kërkojmë në Besëlidhjen e Re, ku e gjejmë definicionin: "Hyji është dashuri" (1Gjn 4,8). Të gjitha mësimet që i kemi nga Jezu Krishti dhe që na lënë mbresa, është ajo Atësi e Hyjit; askush nuk kishte guxuar të pohojë që Hyji është për ne "Abba" (Atë)... jemi të bijtë e Hyjit; ai si Atë, ekziston dhe lëviz përkrah njeriut. Hyji Atë: e Mira, Mirësia, Qenia për esencë; Hyji Bir: Bukuria, e Vërteta; Hyji Shpirti Shenjt: Dashuri, Dhuratë.

Tri vetjet hyjnore i dhurohen

e kundërshton as shkencën as angazhimin e njeriut. Shkenca dhe teologjia duhet të jenë të vetëdijshme për limitet e tyre. Pafundësia e qiellit me yje, bukuria e agimit dhe e perëndimit të diellit, madhështia e majave të larta të maleve, në shtrirjen e detit të thellë e deri te rritja e një lule, janë burimi i një surprize të veçantë për njeriun. Ashtu sikur fëmija mëson nga një i rritur të flasë, ashtu edhe një i rritur mëson ta njohë kozmosin dhe natyrën nëpërmjet një intervënimi të dikujt tjetër që i ndihmon ta lexojë atë. Miliarda e miliarda njerëz kanë jetuar duke e thi-

Shën Ambrozi, ipeshkëv i Milanos (340 – 397)

■ SHKRUAN:
Don Marjan DEMAJ

Jeta e Ambrozit është interesante. Ai arriti që nga ministri i punëve të brendshme të bëhet kryepeshkëv i Kryepeshkëvisë në të madhe në botë, Milanos.

Ambrozi u lind në Gali, në Trier, rreth vitit 340. Ati i tij ishte prefekt. Rrjedh prej një familjeje të krishterë. Si fëmijë vjen në Romë dhe atje studion të drejtën dhe klasikët. Pikërisht kjo ia mundëson të ketë një karrierë të lavdishme. Më së pari shërbeu në Mitrovicë (Srijem). Rreth vitit 373 emërohet udhëheqës i krahinës së Emilisë dhe Ligurisë me seli në Milano. Në këtë funksion arriti tepër i ri, në moshën tridhjetëvjeçare.

Në vitin 374 vdes ipeshkvi i Milanos, i cili ishte mik i mirë dhe dashamir i oborrit mbretëror, por edhe simpatizues i arianizmit. Tani duhej të zgjidhej ipeshkvi i ri, por konfliktet ndër-fetare ishin të mëdha dhe kishin shkakuar trazira të shumta. Çdo gjë ishte turbulluar në pikëpamje fetare në mes të krishterëve, për shkak të arianizmit.

Ndodhi që me një rast të mbahej një mbledhje ndër fetare, në të cilën merr pjesë edhe Ambrozi për ta qetësuar gjendjen, nëse kërkon nevoja. Aty në atë mbledhje u dëgjua një zë nga jashtë: *E duam Ambrozin për ipeshkëv*. Por ai nuk ishte ende i pagëzuar, ishte katekumen që përfaqësoj për pagëzim. Nuk dihej se kush e lëshoi këtë zë, por thonë se ishte zë fëmijë. Njerëzit e tubuar me vëmendje e dëgjojnë këtë zë dhe njëzëri kërkojnë nga Ambrozi për të pranuar ftesën. Nderkaq Ambrozi arsyetohej se ende nuk është pagëzuar. Pas shumë lutjeve e pranon dhe së shpejti pagëzohet, shugurohet për meshtar dhe pastaj për ipeshkëv. Nuk është e tepërt të thuhet se shën Ambrozi është ipeshkvi më i madh dhe më i njohur në historinë e Kryepeshkëvisë së Milanos.

Vepra e parë e Ambrozit, që u pëlqeu njerëzve dhe Zotit, ishte: *shiti krejt çka pati dhe të gjitha mjetet ua ndau skamnorëve*. Kjo tregon se Ambrozi do të jetojë për ta dhe prej tyre. Pastaj prapë fillon shkollimin për të pasur njohuri sa më të madhe fetare. Në veçanti studioi Origenin, Atanasin, Çirilin e Jeruzalemit, Bazilin etj. Por para se gjithash studioi Shkrimin Shenjt, pa të cilin nuk ka jetë, ushtrohej edhe në jetën aske-

tike. Kështu në këtë mënyrë ai përgatitej t'u nënshtrohet plotësisht ligjeve dhe urdhërimeve të Zotit, që si bari të mund sa më mirë t'i shërbejë grigjës që Zoti ia besoi.

Ambrozi e kishte vështirë për ta udhëhequr Kishën. Fillimisht problem i paraqiste zgjedhja e tij për ipeshkëv, në kohën kur ai nuk kishte njohuri të madhe fetare, ishte katekumen. Por me përpjekje maksimale arriti t'i përballojë të gjitha vështirësitë dhe Kisha nën udhëheqjen e tij vërtet lulëzoi. Ambrozi kishte një keshilltar të thjeshtë, por shumë të mirë, i cili quhej Simplicio, meshtar. Ky bëri që Ambrozi të arrijë shumë në jetë. Ambrozi shpejt e kuptoi se *Ungjilli nuk mësohet, por jetohet*.

Ishte gjithmonë i rrethuar me njerëz. Ai jetonte për ta. Një herë shën Augustini kishte dëshirë të takohej me të, por nuk arriti nga turma e madhe e njerëzve. Ishte i rrethuar nga një masë e madhe njerëzish. Ambrozi duke e jetuar dhe përjetuar Ungjillin, u bë predikatar i famshëm i asaj kohe. Sa herë që predikonte, katedra e mbushesh plot e përplot me njerëz të të gjitha moshave.

Ishte trim dhe nuk frikësohej. Me predikimet e veta mendohej t'i bindte edhe zemrat e pushetarëve. Në këtë kohë mbretë ishte Graciani, të cilit predikimet e shën Ambrozit i pëlqenin pamash, sa që një ditë e thirri që t'i mbajë mësim feje. Ambrozi për dallim nga paraardhësit dhe pasardhësit e vet, bëri shumë në kthimin e njerëzve nga herezitë e ndryshme, duke u ndihmuar që ta njohin fenë e vërtetë të Jezu Krishtit.

Për shkak të arianizmit, shën Ambrozi erdhi në konflikt me Teodozin perandor. Për këtë arsye shën Ambrozi disa herë e sulmon Teodozin në predikimet e veta. Fatmirësisht Ambrozi pati ndikim edhe mbi të. Me një rast Teodozi kishte dhënë urdhrë të rrëzohet një tempull në Eufrat dhe bëri që prapë atë ta ndërtojë. Deri atëherë nuk kishte ndodhur që një perandor të përkulej para ipeshkëvit, siç bëri Teodozi para shën Ambrozit. Teodozi perandor me një rast për një gjeneral të vetin, kishte vrarë 7000 vetë. Shën Ambrozi jo vetëm që dënon një masakër të tillë, por Teodozin e largon prej Kishës, duke thënë: *"Në qoftë se Teodozi është mbret dhe ka ndikim në kishë, kjo nuk do të thotë se është mbi të gjithë dhe se ka të drejtë të bëjë çka të dojë. Duket kush është përgjegjës për Kishë."*

Teodozi proteston rreptë për ofendimet që ia bëri shën Ambrozi, por ky nuk e tërhoqi vendimin. Teodozi perandor u detyrua Natën e Krishtlindjes në vitin 390 të vishet me rroba pendestare dhe haptazi, para të gjithë atyre besimtarëve të shumtë që ishin në kishë, të kërkojë falje për krimin e bërë. Kjo vërtet ishte mrekulli, që ndikoi pozitivisht në vetë Teodozin, i cili tani e tutje jetoj si besimtar i mirë, pa tentuar që të ngritë mbi të gjithë dhe të bëjë siç bënin perandorët e tjerë.



Veprat

Veprat e shën Ambrozit janë të shumta dhe tërheqëse.

Veprat mbi Shkrimin Shenjt

Veprat egzegetike:

a) *Shpjegimi i Ungjillit sipas Lukës*. Kjo veprë ka vlerë shpirtërore dhe dogmatike. Në këtë veprë ruhen edhe disa fletë të kushtuara Jonjës së Bekuar, duke e pasur parasysh se vetëm në Ungjillin sipas Lukës shkruhet mbi Jonjën.

b) *Hexameron* – Mbi gjashtë ditët e krijimit. Kjo është një veprë e ndarë në gjashtë vëllime

dhe përfshin nëntë fjalime të mbajtura në Javën e Madhe. Në këto fjalime vërejmë se Ambrozi i çmon shumë Origenin dhe Bazilin, por thellohet shumë më tepër në mendimet e tyre.

c) *De paradiso* – Mbi parajsën. Kjo veprë është një komentim mbi parajsën e tokës dhe ramjen e njeriut të parë. Këtu ka edhe raste kur polemizon me gnostikët, maniheistët dhe arianët, sekte të ndryshme të asaj kohe.

Ambrozi ka edhe vepra tjera të ngjashme, por që janë ndoshta më pak të rëndësishme.

veçantë nderit. Nëse është nevoja, i krishteri edhe me jetë duhet të paguajë për mos ta çnderuar besimin në Zotin. A thua nuk vepruan kështu edhe martirët para nesh?

Ambrozi shkruan edhe disa vepra mbi virgjerinë.

Veprat dogmatike:

a) *De fide, ad Gratianum* – Mbi fenë, drejtuar Gracianit. Graciani ishte perandor dhe kërkon nga Ambrozi që të shkruajë mbi fenë, për ta mbrojtur atë prej heretikëve, gjegjësisht të shkruajë për hyjninë e Fjalës së mishëruar. Vepra ka pasur pesë vëllime. Ambrozi argumenton se *Biri është i njëjti me Atin, dhe se Ai nuk ka pasur fillim dhe nuk ka mbarim. Biri nuk është i krijuar. Ai është i mirë sikurse Ati dhe është Zot i vërtetë. Biri nuk ka hyjni tjetër veçse të njëjtë sikurse ka edhe Ati*.

b) *De Spiritu Sancto* – Mbi Shpirtin Shenjt. Qëllimi i kësaj shkrimi ishte, sikurse vepra e parë, argumentimi i hyjnisë së Shpirtit Shenjt, i cili është i ngjashëm me Atin dhe Birin.

c) *De sacramentis* dhe *De mysteriis* – Sakramentet dhe Misteret. Është kjo një katekeze për të pagëzuarit e ri. Këtu Ambrozi shpjegon bukur pagëzimin, krezimin dhe kungimin.

Mendoj se është me rëndësi që t'i cekim edhe disa fjalime. Këtu po e citojmë fjalimin që mbajti me rastin e vdekjes së Valentinianit perandor. Perandori vdiq si katekumen. Vdiq në moshën 22 vjeçare. Ambrozi ndër të tjera tha: *"Në qoftë se martirët janë të larë me gjak, ky Valentiniani është i larë me përsëritëri dhe vendosmëri që ta ndjekë Jezu Krishtin..."*

Edhe pak fjalë si përfundim për shën Ambrozin. Ky shenjt jetoj dhe punoi në kushte dhe rrethana të vështira dhe të rrezikshme. Në atë kohë dominonte kriza e madhe në mes shtetit dhe Kishës. Lirisht mund të themi se shën Ambrozi ishte njeriu i duhur, në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, i cili nuk lejoi që perandori me autoritetin dhe fuqinë e vet të udhëhiqte Kishën siç kishin bërë më parë. Për më tepër ai nuk lejoi as shkëlqen e ligjit dhe moralit nga askush, qoftë ai edhe mbret. Ambrozi arriti që t'i çrrënojë këto dukuri negative. Ambrozi me askënd nuk ishte në armiqësi, pra as me shtetin. Ai në këtë mënyrë e mbronte edhe autonominë e Kishës.

Mendime dhe orientime mbi familjen

Familja edukon sot?

Misioni i familjes në realitetin aktual

Edukimi i krishterë është ai i cili e tregon udhërrëfyesin e besimit pors i rrugë unike, e cila shpie në jetën e vërtetë, në lumturi. Besimi bëhet ndërmjetësues i domosdoshëm, me të cilin edukimi i krishterë jep kontributin e vet të fortë, pra mënyra e të menduarit: pors i kriter i vlerësimeve tona; rregulla e fundit e zgjedhjeve tona. Me një fjalë: bëhet forma e jetës sonë. Bëhet dhe është një STIL i jetës.

■ SHKRUAN:
Don Lekë Oroshi s.d.b.

Para se të hymë në temë, më duhet ta bëj një hyrje të rëndësishme. Kur flitet për familje pors i vendqëndrim në të cilin formohet njeriu – personi, shpeshherë biem në rrezik të zhvillojmë një temë, thjesht apeluere; edhe më keq, shpeshherë mundohemi të japim rregulla morale të llojllojshme. Pra, një bisedë në të cilën apeloheh prindërit si duhet të veprojnë dhe si nuk duhet të veprojnë me fëmijët e tyre, me rrezik se ata kthehen në shtëpinë e tyre të dëshpëruar, se nuk janë as afër mënyrës dhe rregullave morale.

Në këtë shkrim pra, kam qëllim të ofroj disa mendime nga ky këndvështrim, të definoj se familja është celula kryesore e një rilacioni të dashurisë mes personave. Familja ka në vetvete dhe për vetvete forcën dhe mundësinë, të dojë dhe të edukojë persona. E kur them “familje”, nënkuptoj familje që, edhe pse në mes shumë vështirësive të të përditshmes, dhe të pengesave të çdo lloji, jeton normalitetin e vet të përditshëm, me respekt dhe dashuri.

Duhet të kemi një ide të qartë se çdo të thotë “edukimi i personit”; e qartë, se sot nuk mund ta japim për të sigurt këtë gjë. Prandaj ky shkrim do ta ketë këtë renditje: në pikën e parë do të mundohem t’ua jap dhe t’u them se çka nënkuptoj për edukim të personit dhe në fund do ta përmbyll këtë me disa mendime praktike dhe të thjeshta.

Të Edukosh personin

A ju ka ndodhur ndonjëherë të takoheni me një person, i cili ju ka pyetur një lloj rrugë për të arritur në një qytet? Është një metaforë e madhe në aktin e edukimit.

E dimë të gjithë, se edukimi e ka si destinim personin, i cili sapo ka arritur në këtë botë. Ai person arrin në këtë botë duke qarë dhe duke vuajtur, me një pyetje të madhe në zemër: cila është rruga të cilën duhet ta zgjedhë për ta arritur LUMTURINË? Të ndalemi pra, një moment dhe të mendojmë mbi këtë pyetje të madhe.

Fola pra, për “LUMTURI-NË”. Mos e merrni këtë fjalë në kuptimin e saj banal që e ka men-



taliteti i sotëm gjuhësor. Secili prej nesh dëshiron lumturinë në kuptim të jetës së vërtetë, të një jete më të mirë. Jo çfarëdo apo si do qoftë. Janë disa momente ku ne i kuptojmë, bëjmë përvorje se është jeta e vërtetë! Ose në mënyrë negative, sepse jetojmë në një situatë ku mund të themi: “po çfarë jete është kjo? Kjo nuk është jeta!”, ose në mënyrë pozitive, sepse përjetojmë gjëra të bukura dhe themi: “oh, po të ishte e tërë jeta në këtë mënyrë!”.

Kur një person hyn në këtë botë, nuk ecën kah asgjëja, por vetëm kah ky qëllim; nuk dëshiron gjë përpos këtij qëllimi. Ecja e jetës e ka këtë orientim themelor.

Personi i posa arritur a ka nevojë në këtë ecje të jetës për orientim? A ka nevojë që t’i tregohet rruga? Në qoftë se ndaleni dhe mendoni për disa çaste çështjen njerëzore, do ta kuptoni se në mes të të gjitha krijesave, njeriu është ai i cili më së voni e arrin autonominë e vet, vetëvendosjen e vet, autodeterminim e vet.

Në planin biologjik këtë gjë është më lehtë ta konstatojmë. Por jo vetëm këtë. Kush ka fëmijë, e kupton se shpejt do të “shqetësohen” nga fëmijët, me “pse-hat” e tyre. Ekziston në personin e posa arritur në botë, një dëshirë për të ditur të VËRTE-

TËN e gjërave, për të NJOHUR arsyet e gjërave që ndodhin. Nuk ka lumturi në qoftë se nuk u jepen përgjigjet pyetjeve tona.

Pyetja e rrugës së lumturisë është një pyetje rreth të së vërtetës. “Felix qui potuit rerum cognoscere causas” ka thënë Virgili, që do të thotë: “I lumtur është ai, i cili i ka mundur të hyjë në esencën e gjërave”, në Gjeorgjike, II, 489.

Një ndër imazhet më të bukura që përdoren për të përshkruar jetën e njeriut është pra, ajo e lundrimit: jeta është pors i një kalim i detit, kah porti i lumturisë. Është e domosdoshme të dihet si të lëvizim, duhet njohur rregullat e lundrimit. Jashtë imazhit, personi i posa arritur në jetë ka nevojë të jetë i orientuar në ushtrimin e lirisë së vet; ka nevojë të njohë atë çka është e mirë dhe çka është e keqe, dhe të dijë të dallojë, dhe të ndihmohet për ta zgjedhur të mirën.

Edukimi i personit pra, është të ndihmohet për ta gjetur rrugën, e cila do ta shpjerë kah një jetë e re dhe e mirë. Me një fjalë: kah LUMTURIA. Mund tani ta thjeshtësoj dhe të marr shembull nga shumë gjëra të përditshme, shumë të thjeshta. Mjafton t’i hapim sytë dhe veshët. Por nuk do ta zgjasim shumë. Gjer më tani e kam përshkruar faktin

edukativ pors i fakt universal të njerëzimit. A është pra edhe një fakt i krishterë ky? Patjetër. Ta shohim si?

- Mund ta analizojmë dialogun e kremtimit të sakramentit të Pagëzimit të fëmijëve (konfr. Me letren e Papës Benediktit të XVI, letëra Enciklike, Spe Salvi, 10).

Meshtari e pyet fëmijën (natyrisht në personat e prindërve dhe të nunave): “çka kërkoni nga Kisha?” dhe fëmija përgjigjet: “Besimin”. Meshtari e bën pyetjen e dytë: “e çka të jep feja?”; fëmija përgjigjet: “Jetën e Pasosur”.

Nuk është vështirë të shohim në këtë dialog strukturën e aktit edukativ, të cilin pak më parë e kemi shpjeguar. Kisha pra, ndihmon personin e posa ardhur në botë të vetëdijësohet dhe të marrë përgjigje në pyetjen, nga dëshira të cilën e ka në zemër, lumturinë. Dhe në të njëjtën kohë e pyet çfarë pret nga Kisha; çfarë aspirata ka ndaj Kishës.

Personi i posa arritur në këtë botë pret nga Kisha besimin. Kujdes këtu. Besimi këtu nënkuptohet atë në çka Kisha beson, doktrina e fesë është edhe aspekt subjektiv individual, por është edhe virtyt i besimit. Mund të themi, “kërkoj nga Kisha të jetë e edukuar në fe”. Dialogu vazhdon të jetë gjithnjë e më i qartë, dhe Kisha bën pyetje për të “rizgjuar mendimet e zemrës”: “pse kërkoni të jesh i edukuar në fe?”. Personi i posa arritur në botë thotë: “kërkoj të jesh e edukuar në fe, sepse mendoj që kjo është rruga e cila më shpie në jetën e vërtetë, në një jetë të mirë, në jetën e pasosur”.

Edukimi i krishterë është dhe nënkupton të tregojë rrugën e besimit pors i vetmja rrugë e cila shpie kah jeta e amshuar, e pasosur, kah lumturia e vërtetë. Besimi kështu bëhet, nëpërmjet edukimit të krishterë, mënyra jonë e të menduarit, e të jetuarit si dëshmitar dhe si të vërtetë; kriteret e vlerësimeve tona; rregulla e fundit e zgjedhjeve tona. Me një fjalë: është forma e jetës tonë. STILI I JETËS TONË.

Kemi thënë më sipër se lundrimi është një metaforë e madhe e jetës njerëzore. Dua tani t’ua lexoj në mënyrë të shkurtër dhe të komentoj një faqe të shën Augustinit që po më duket një

përshkrim oreksues i edukimit të krishterë. “Sikur që ndokush mund të shohë nga larg atdheun, por në mes e ka detin që e ndan nga ai. Ai e sheh se ku duhet të shkojë, por i mungon mjeti me të cilin do të udhëtojë. Kështu është edhe për ne, të cilët dëshirojmë të arrijmë stabilitetin tonë, ku ajo që është, është, sepse ajo që është gjithmonë është ashtu siç është. Prandaj, deti është në mes të këtij shekulli nëpër të cilin duhet të ecim, në ndërkohë të tjerët nuk shohin as ku do të shkojë. Për këtë, edhe ta kishin mjetin me të cilin mund të ecin, vjen nga atje, Ai, nga i cili donim të shkonim. E çka bëri? E përgatiti drurin me të cilin të mundim ta kalonim detin. Në fakt, askush nuk mund ta kalojë detin e këtij shekulli, pa u bartur me Kryqin e Krishtit. Pra, në këtë Kryq mund të shtrëngohen, edhe ata të cilët i kanë sytë e sëmurë. E kush nuk mund të shohë kah duhet të shkojë, mos të shpëputet nga Kryqi, sepse Kryqi do ta shpie” (Komenti i Ungjillit të Gjonit, II, 2).

Nëpërmjet edukimit të krishterë, në mësojmë të mendojmë pors i Krishti: të kemi mendimin e Krishtit; të përjetojmë dhe të jetojmë pra, lirinë e Krishtit, lirinë tonë: të duam pors i Krishti. Dhe kështu arrijmë tek LUMTURIA. “Duke i ditur këto gjëra, do të jeni të lumtur në qoftë se e vëni në praktikë” (Gjoni 13, 17), tha Jezusi pasi që u lau këmbët apostujve të vet.

Personi i posa arritur në këtë botë e pyet Kishën për këtë, të jetë i edukuar në Fe. E pyet Kishën të ia tregojë rrugën e LUMTURIVE.

Një nga dukuritë themelore të edukimit të Kishës është FAMILJA.

Përrbyllje

Nuk e kam përmendur, në aspektet themelore të edukimit familjar, atë të autoriteteve. Për këtë ndoshta njëherë tjetër. Kjo çështje më nxiti të dëshmoj personalisht “nxitjen edukative” tek lexuesit dhe prindërit. Tani po e përfundoj me një mendim shumë të rëndësishëm. Në propozimin tuaj edukativ, ju mos u nisni nga zëroja. Jeni pra, brenda një TRADITË TË MADHE EDUKATIVE, si është kjo e besimit të krishterë, e Kishës, e cila ka gjallni dhe është aktive. Mos u shpëputni asnjëherë nga ajo.

Muaji tetor, muaj i ku

■ SHKRUAN:
Don David GJUGJA

Fort të dashur lexues, shkruan Papa Benedikti XVI: "Njeriu nuk fillon të jetë i krishterë në sajë të forcës së një vendimi etik apo të një ideje të madhe, por në sajë të takimit me një Person që i jep horizonte të reja jetës". Lutja e rruzares nuk është tjetër përveç se kundrim i fytyrës së Krishtit bashkë me Marinë. Kjo uratë mariane është kryesisht kristologjike. Nuk ka kurrfarë dyshimi se Maria na ndihmon shumë ta kundrojmë fytyrën e Zotërisë Jezus, sepse asnjë person tjetër si ajo nuk i është kushtuar me aq zell e vullnet kundrimit të fytyrës së Birit të vet.

Gjatë muajit tetor Kisha na fton që bashkë me Virgjëren Mari ta kundrojmë fytyrën e Shëlbuesit tonë, Jezu Krishtit, përmes lutjes së Rruza res së Shenjtë. Kështu besimtarët e krishterë mbledhen nëpër Kisha e familje për ta nderuar e lutur Virgjëren Mari me titullin e "Zojës Rruzare". Sikur dihet, janë të shumtë titujt e emrat me të cilët populli i Zotit e nderon dhe lut Nënë Qiellore, e secili prej këtyre emërtimeve tregon në një mënyrë tejet të veçantë mbrojtjen e saj, ndërmjetësimin e saj, mësimin e saj, rolin e saj dhe dashurinë me të cilën Zoja e Bekuar na përcjell çdo cast në udhën e jetës sonë shpirtërore drejt Jezu Krishtit, Shpëtimtari të botës.

T'i kujtojmë titujt më të njohur me të cilët Nëna Hyjnore nderohet në viset tona shqiptare, pa shkuar më larg si në Lurdë, Fatima, Pompei, Cestohovë, Guadalupe e vende tjera të botës: Zoja Ndhimëtare në Prizren, Zoja Cërna Gore në Letnicë, Zoja e Madhe e Hasit në Zym, Zoja e Këshillit të Mirë në Shkodër, Klinë e Guri Zi, Zoja Rruzare në famullinë e Bishtazhinit e sa e sa kisha në vende tjera.

Kjo larmi titujsh apo emërtimevish do të thotë se ne i drejtohem Virgjëres Mari për çdo nevojë që kemi, qoftë shpirtërore po edhe trupore. Me një fjalë, mund të pohojmë se nuk ka situatë të jetës që nuk na frymëzon për një lutje të veçantë, të përzemërt e plotë fe ndaj Zojës së Bekuar, sepse nuk mund të bëjmë e të jetojmë pa Nënë tonë të dashur Hyjnore.

Këtë lidhje shpirtërore kaq të fortë mes Zojës së Bekuar e njerëzimit, e rrefen historia dhe ngjarjet e shumta të njerëzimit anë e mbanë botës, e dokumenton jeta e shenjtëve ashtu si jeta e përditshme e familjeve, e njerëzve të thjeshtë e ajo e personaliteteve dhe gjinive të njerëzimit, siç dëshmojnë veprat e artit nga muzika klasike si Bach, Mozart, Hendel, Perosi e deri te piktura si vepra 'Lajmërimi i "Engjëllit Tenzot Zojës

shëm e vendimtar për ne, njerëzit, ai pranë Kryqit të Shenjtë të Shëlbimit, prej nga Jezu Krishti i kryqëzuar na besoj përgjithmonë kujdesit e dashurisë amënore të Nënës së tij e Nënës sonë Virgjëres Mari. "Nënë, ja biri yt, bir ja Nëna jote". E ne gjatë muajit tetor e falënderojmë Krishtin Zot pse nuk na la jetim pa Nënë. Kjo lidhje shpirtërore ka mbërritur deri në ditët tona përmes Kishës, e cila në muajin tetor mbledhet rreth Nënës Qiello-

Hyjnore na pranon të gjithëve, pa dallim, të varfër e të pasur, të mirë e të këqij, zemra e Nënës është gjithmonë e gatshme të na përqafojë e kthejë në rrugën e jetës, të na kthejë tek Biri i saj e Shpëtimtari ynë, Krishti Zot.

Prandaj në tetor, Kisha e bashkë me të edhe të gjithë ne si besimtarë, duke e përshëndetur Marinë, Nënë e Zotit me emrin 'Zoja Rruzare', e falënderojmë për ndihmën e çmueshme që nuk refuzon t'i japë të gjithë njerëzimit. Virgjëra Mari na afron përreth vetes për të na mësuar udhën e jetës në Jezu Krishtit e ky mision i saj amënor nis qysh në zanafillë të krishterimit, sikur pohon leximi i parë i festës së Zojës Rruzare nga Veprat e Apostujve "Apostujt ishin të përqendruar prapë në bashku në uratë me Marinë, Nënë e Jezusit e me vëllezërit e tij" e gjatë tërë historisë mese dymijë vjeçare të krishterimit, deri në ditët tona, sikur dëshmon jeta e personave dh vendeve të ndryshme.

Kremitimi i Zojës Rruzare, Nënës së Zotit nuk është si kremitimet të tjera. Ka një shije, bukuri e domethënie të posaçme. Zakonisht kur kremitojmë e përkujtojmë një personalitet të historisë, mendojmë për jetën e kaluar, mendojmë për sendet e kaluara, kujtojmë faktet e kryera prej atij personaliteti e për trashëgiminë që ai ka lënë pas. Me Nënë e Zotit nuk është kështu. Zoja e Bekuar nuk flet për vetveten por për veprat e madhërishtme që Zoti ka bërë përmes saj për mbarë njerëzimit. Ajo na takon me Zotin e na porositë gjithmonë të bëjmë ashtu siç na thotë Jezusi.

Pak histori mbi rruzaren e shenjtë

Kështu pra, me kalimin e kohës, devocioni ndaj Zojës së Bekuar e lutja e Rruzares përhapet. Pikturat e figurat tradicionale të Zojës Rruzare, e paraqesin Marinë në sa me njërin krah mban Foshnjën Hyjnore e me tjetrin i jep Shën Dedës Rruzaren. Kjo ikonografi kuptimplote tregon se "Cekici i heretikëve" në duar të Shën Dedës, themeluesit të fretërve predikatarë dominikanë, në luftimin e heretikëve albigezë të shekullit XII në Francë,



Mari" e Fra Angelicos më 1430 (në Prado), skulptura si 'Pietà' e Michealngelos (1499 që gjendet në shën Pjetër-Vatikan), poezia (si himni që Dante Alighieri ia kushton Virgjëres Mari në 'Komedinë Hyjnore' e tjerë si Jul Variboba me 'Gjellën e Shën Mërisë Virgjër', Atë Gjergj Fishta, don Ndue Bytyçi e sa e sa të tjerë etj).

Të gjitha këto vepra e kryevepra rrëfejnë lidhjen e veçantë shpirtërore që ekziston ndërmjet njerëzimit e Nënës së Zotit, që nga cast i Lajmërimit të Engjëllit të Tenzot Vigjërës Mari në Nazaret e deri tek çasti i dhimb-

re, sikur pohojnë edhe Veprat e Apostujve.

Ja se pse mund të themi se Maria vërtet është kryevepër e Zotit, krijesë e mrekullueshme që Hyji Atë i ka dhuruar njerëzimit për ta shpëtuar nga çdo e keqe e për ta shëlbuar çdo njeri. Edhe atëherë kur fuqia e mendja njerëzore është e pafuqishme dhe e errësuar nga mëkati e nga e keqja, dora e Nënës Hyjnore e bënë të pamundurën vetëm e vetëm për të na shpëtuar nga çdo e keqe e nga vdekja e përjetshme, sepse Nëna Hyjnore na do si bijtë e vet, bijë e bija që Jezu Krishti ia besoi nga Kryqi. E Nëna jonë



Ishtuar Zojës Rruzare

ishte pikërisht lutja e Rruzares. E urdhri i Dominikanëve ka një meritë të madhe në përhapjen e lutjes së Rruzares me meditimën e mistereve të fesë ndër besimtarë të krishterë. Elementi tjetër i ikonografisë së Zojës Rruzare me Shën Dedën e Shën Kanarinën e Sienës, tregon se Rruzarja është mjet që Zoja e Bekuar na dhuron për ta kundruar e njohur Jezusin e, duke medituar për jetën e Tij, ta duam e të ecim gjurmëve të tij gjithmonë e më besnikërisht.

Vetë Zoja na ka porositur ta lusim Rruzaren në disa dukje të saj si në Lurdë, Fatima, Medjugorje e vende tjera.

Po le të vijojmë historinë e Rruzares me radhë e të themi se Festa e Zojës Rruzare që themeluar nga Papa Shën Piu V, dominikan edhe ky, në shenjë falënderimi e mirënjohjeje ndaj 'Zojës Ndihmtare' në një moment vendimtar të historisë së Evropës, të fateve të Kishës e të krishterimit. Ishte 7 tetori i vitit 1571 e në Lepanto në betejën detare historike u ndal sulmi më i dhunshëm i otomanëve kundër perëndimit të krishterë, që synonin të depërtonin në zemër të Evropës. Papa Piu V e konsideroi këtë fitore kundër turqve, si ndihmë e vepër të Zojës së Bekuar e duke dashur ta falënderonte Nënë Hyjnore, themeloi më datën 7 tetor Festën e së 'Lumës Virgjër të Fitoreve'. Më pas vijjnë fitoret tjera si ajo e vitit 1683 në Vjenë dhe ajo e vitit 1716 në Petervaradin.

Në vazhdim të historisë, kemi një përhapje e afirmim gjithnjë e më të madh të Rruzares Shenjte ndër kuvende murgjish, rregulltarësh e sidomos në popullin e krishterë deri në kohën e Papës me origjinë shqiptare, Klementit XI, i cili më 1716 festën e Zojës Rruzare e caktoi të kremtohet në të dielën e parë të tetorit duke përhapur e zyrtarizuar në mbarë Kishën.

Pra, duke përshkuar historinë, shohim se si lutja e Rruzares ishte mjeti me të cilin Zoti e mbrojti popullin e tij (të krishterë) në periudha historike shumë të stuhishme prej rreziqeve të mëdha e të ndryshme.

Nëse në të kaluarën, rreziqet ishin të dukshme, në kohën e në

shoqërinë tonë, rreziqet që kërcënojnë jetën njerëzore e vlerat morale janë të padukshëm, po veçanërisht të dëmshme e reale si ...egoizmi, indiferenca, hedonizmi, mashtrimi, kompromisi me të keqën, bashkëjetesa me mëkatën e të tjerë. Prandaj, si në të kaluarën ashtu edhe sot, është e domosdoshme të vazhdojmë të mbështetemi në fuqinë e lutjes së Rruzares e në ndërmjetësimin e Marisë Virgjër, jo vetëm për paqen ndërmjet njerëzve, familjeve, popujve, por edhe për pajtimin e bashkëjetesës e mirë e vëllazërore ndërmjet besimtarëve të feve të ndryshme. Sot është urgjente ta kthejmë Rruzaren në jetën tonë personale, në familjet tona e në Vendin tonë.

Pse ? Rruzarja është uratë e popullit të Zotit, e thjeshtë, e kuptueshme për të gjithë, e lehtë për t'u thënë në çdo çast e vend. Sepse Zoja e Bekuar e ka shumë përzemër bash lutjen e Rruzares e i porosit shumë besimtarët ta lusin rregullisht, se vetëm përmes uratës mund t'i fitojmë hirit Hyjnore e të gjejmë forcën për të qëndruar denjësisht në rrugën e Zotit e larg të këqijave që kërcënojnë e rrezikojnë jetën.

Prandaj, jam i bindur se të gjithë njerëzit, të çfarëdo formimi e kategorie pune e shoqërore qofshin, që të gjithë pa dallim, kanë nevojë për këtë gurrë shpirtërore, për përkëdhelje të Nënës Hyjnore, sepse lutja e Rruzares është përkëdhelje e Zojës së Bekuar, është buzëqeshje e Nënës Hyjnore. E sot, kur të kthehemi ndër shtëpi, ta sjellim në familje tona bekimin që Zoti na dhuron përmes buzëqeshjes së Zojës Rruzare.

Rruzarja është gjetje (shpikje) e madhe e Marisë për ta na mbajtur afër vetes e të bashkuar në një familje të vetme, afër Krishtit, me Krishtin e në Krishtin. Vet Virgjëra Mari, personalisht u denjua të na mësojë e porosit këtë uratë të përsëritshme të Rruzares ta lusim çdo ditë e ta kemi spirancë shpëtimi.

Personalisht nuk e harroj kurndë dëshminë e kardinalit **shqipëtar don Mikel Koliqi**, i cili me rënien e komunizmit e rifitimën e lirisë në Shqipëri, pas 29 vjetësh që kishte kaluar në kampe

të përqendrimit duke pësuar çdo lloj torture, në një bisedë në shtëpinë et tij shumë modeste në Shkodër, ku jetonte me familje, më tha se "forcën e qëndrësës përballë përbindëshit komunist e torturave çnjerëzore që duroi, e kishte në lutjen e Rruzares, pa zë, por me fe, pa ruaza, por me gisht. Zoti me ndërmjetësimin e Zojës së Këshillit të Mirë, më ka shpëtuar prej rrezikut e vdekjes – më tha kardinal Koliqi. Në momentet më të tmerrshme të

torturave, një të Falem Mari, më forconte shpirtin, se trupi ishte i rraskapitun....

Po, lexues të nderuar, Rruzarja është mrekullibërse.. Nuk do ta harroj kurrë **shembullin** e jashtëzakonshëm e unik, të bijës, motrës, e Nënës sonë, **të Lumës Nënë Terezë**, kur më 25 prill 1993 gjatë vizitës historike të Papës Gjon Palit II në Shqipëri, e Lumja Nënë Terezë kishte dalë në aeroportin e Rinas-it për ta pritur Papën Wojtila. Në mo-

mentin e përqafimit atëror me Papën, i tregoi Rruzaren e Zojës duke ngritur dorën e thënë: "Kjo liri e popullit tim nga tirania, kjo vizitë e juaja, Ati Shenjtë, në vendlindjen time, është dhuratë e meritë e Nënës së Zotit."

Edhe ne pra, le t'i ri-kthemi lutjes së Rruzares, kësaj urate kaq të thjeshtë dhe të fuqishme e do të zbulojmë e shijojmë bukurinë, e madhësinë e jetës nën mbrojtjen amënore të Nënës Qjellore.

Besimtarë të devotshëm të Zojës Rruzare





Intervistë me don Anton Kçirën, meshtar në kishën e Shën Palit në Detroit

Në shërbim dhe veprim nën "hijen" e Gjergj Kastriotit në Detroit

Njerëzit ishin të përçarë në grupe e parti. Mirëpo a ishte situata e mirë? Gjatë këtyre viteve kishin hyrë armiqtë në mesin e njerëzve aq shumë, sa që ka pasur vrasje e hakmarrje, e numri i tyre arriti deri në dyqind veta që janë vra e varrosur në vendet kah kanë ardhë. Kështu që fillova të predikoj kundër vëllavrasjes, e cila s'është e shpejti u fik. Përpos kësaj, ia fillova luftën kundër drogës dhe kundër ndasive e përçarjeve, kështu që filloi të dalë në pah suksesi: shumë familje i ribashkova dhe u fola për rëndësinë e kurorës shenjte, të cilën duhet ta ruajmë si sytë e ballit. Shkatërrimi i familjeve është tragjedia e njerëzimit. Nëse arrihet ky institucion të shkatërrohet atëherë çka do t'i mbetet botës? Në vitin 1992, kur u përzunë nga puna shqiptarët kemi bërë një aksion në kishë ku për një orë janë grumbulluar \$64,400, e ato i kemi dorëzuar në bankën e Libtenshtajnit. Kuptohet për bukë të të varfërve, por nuk di a kanë arritur deri te goja e nevojtarit a jo?! Në vitin 1998, kur filloi flaka në Drenicë, një mbrëmje në kishën tonë janë bashkuar \$189,000.

Don Anton, keni shërbyer me një sukses të madh për 19 vite me radhë në famullinë e Shën Ndout në Glogogjan. Cili ishte motivi që ju shtyri të vini këtu, në Amerikë?

Don Anton: Ta themi të vërtetën, Zoti i ka planet e veta. Unë prej vitit 1972 kam ardhur për çdo vit në Amerikë në vizitë të prindërit, por mund të them se asnjëherë nuk me ka shkuar mendja për t'u vendosur në Amerikë. Më kujtohet në vitin 1985 e kam pasur një ofertë nga kisha e Don Lazër Sheldisë të cilin më vonë e kanë pasë masakruar disa shqiptarë. Më kujtohet një takim me ipeshkvin e New York-ut ku një monsinjor, emri i të cilit më nuk më kujtohet, më tha: "Nëse është nevoja që, në rast që ipeshkvia jote nuk të lejon, ti mundesh me i marrë sendet tua dhe të vish këtu e ne kem për të të pranuar. Por për fat, as ajo nuk ma mbushi mendjen. Gjatë këtyre viteve që kam ardhur, rregullisht e shihja situatën, e ajo ishte një situatë e palakmueshme.

Pra po filloj të përgjigjem në pyetjen tuaj. Arsyeja, e cila më solli këtu, ishte shumë e çuditshme. Në verën e vitit 1989 kishite qarkulluar një letër nga dioqeza e Shkup-Prizren tek të gjithë meshtarët që nëse do të kishite pasur ndonjë vullnetar për Detroit. Ajo letër pikërisht mua nuk më kishte ardhur, e pse, nuk e dija, por përmbajtja ishte e qartë. Pas Zojës së Madhe ipeshkvi Joakim Herbut e kishte dërguar sekretarin e vet, i cili erdhi personalisht në Glogogjan dhe më lajmëroi se me duhej të takohem me ipeshkvin me datën 21 gusht 1989. Unë atë ditë u bërë gati dhe shkova në Shkup ku iu lajmërova ipeshkvit për atë që me kishte ftuar. Pas përshëndetjes me pyeti:

Shtatorja e Skenderbeut në oborrin e Kishës së Shën Palit në Detroit



a kisha për të shkuar në Detroit. Ju përgjigja se për letër kam dërguar, por mua nuk më ka ra në dorë. Atëherë ai e çeli bisedën, se si ka ardhur nga Nunci Apostolik, që një meshtar të pjekur ta dërgojmë në Detroit. Ipeshkvi më pyeti: "Çka mendoni ju?" I thashë se për sa më takon mua, unë nuk e shoh veten të aftë për të shkuar atje dhe i tregova disa gjëra që i kisha dëgjuar dhe nuk e vazhdoi më tutje bisedën dhe e vërejti se unë nuk isha i vullnetit të shkoj në Detroit.

Por pasi u ktheva në shtëpi filluan disa shenja jo të mira të më lajmërohen. Unë gjithmonë kam qenë gojë palaq, nuk jam kursyer askund të bëj kritika, e sidomos gjatë demonstratave që ndodheshin në atë kohë, vrasjet e pafajshme të moshave të ndryshme. Ndërsa brenda komunitetit tonë katolik ishin disa anomalitë që nuk kishite kush kujt çka t'i tregojë. Në këtë kohë kishin ndodhur disa vrasjet të ndyta: vëllau e kishite vra vëllanë në Bec, në Atmagjë djali babën për një nuse, e më parë në Sallagrazhdë baba djalin, babën e shtatë fëmijëve. Unë predikoja nga altari e thosha: "Ju po vriteni

njeri me tjetrin në këtë mënyrë, si me e vra thiu që e bani gati për dimën, por me dalë e me e vra amnikun që na vret e na djeg tani gati një shekull atë nuk mundemi...". Në kishë gjithmonë i kemi pasur njerëzit e tyre, të regjimit, që kanë raportuar prej të dielës në të diel lajmet dhe fjalët e ndryshme që i kam thanë në atë kohë kundër serbëve. Situata ime ishte rënduar mjaft shumë vite me radhë, sepse në vitin 1974 e kisha ndërtuar kishën e Gllaviqicës pa lejen e tyre, kishën e Poterqit gjithashtu, si edhe rellimin e kishës së Glllogjanit e gjërat tjera me radhë, kështu që unë isha bërë "sorrë e zezë" për ta. Fati i im që në atë kohë kam marrë disa hapa që më kanë mundësuar pa e ditë askush të shkoj për Amerikë. Kështu që i kisha filluar përgatitjen e rrrobave dhe librave dy javë më parë edhe një ditë të shtatorit më vjen situata ashtu aq në rrezik, sa që të jem apo mos të jem.

Ditën e Zojës Vogël shkova në Letnicë dhe aty iu lajmërova ipeshkvit si kandidat vullnetar që të shkoj në Amerikë, se nuk kisha rrugëdalje tjetër. Ipeshkvi



Kisha e Shën Palit dhe objektet përçjellëse

i befasuar, fshani një herë dhe e aprovoi propozimin tim. Kështu që ai më këshilloi ta realizoj sa më shpejt. Kështu, u largova nga Kosova menjëherë duke ia dërguar librat e famullisë ipeshkvit në Shkup me llogaritë e ndryshme dhe u largova pa e ditë as njeri i gjallë as në famulli as kund gjeti. Pasi jam larguar nga famullia, paskan ardhur nja disa makina të policisë nga Prishtina dhe e kishin rrethuar kishën duke më kërkuar, por motrat u kanë thënë se ai ka shkuar për Amerikë.

Më vonë më ka rrëfyer njëra prej motrave: "Ato ditë kur ju jeni larguar nga Glllogjani, ka ardhur një i SUP-it të Pejës me një fëmijë të sëmurë në orët e vona të natës dhe duke biseduar ndër të tjera më tha: "A e njihni don Anton Kçirën." I thashë: "ai është famullitari i im." Më tha: "a bën me folë në besë mos me i tregue kujt gjë? Po, ju përgjigja. Ai vazhdoi, e kemi pasur një mbledhje këto ditë pikërisht për të si me e arrestue dhe mos me i mbyjtë, por me e copëtue. Të lutem, më tha, mos ta dije kush. A din gjë ku është?" Ai vinte me e pa të bi-

rin për çdo ditë në spital, por në orët e vona kur askush nuk ishte andej. Një ditë i thashë se ka arritur në Amerikë. Tha: "Hvala Bogu" (Falemnderit Zotit!). Kur kam ardhë në vitin 2002 për 90 vjetorin e masakrave të Lugut Baranit në Pejë, jam takuar me një individ i cili ka qenë një funksionar i lartë në SUP të Pejës dhe më tha: "Për kime të kalit ke shpëtuar, don Anton!" Kjo ishte arsyeja që e lëshova Kosovën pa e ditje se çka më priste, as në Kosovë, as në Detroit, por unë besoj se kjo ka qenë vetëm provania e Zotit për të shkuar atje ku unë nuk dëshiroja të shkoj.

E dimë nga përvoja njerëzore që çdo fillim është i vështirë. Si ka qenë për ju fillimi i shërbesës suaj në bashkësinë apo komunitetin katolik në Detroit? Cilat ishin vështirësitë?

Don Anton: Kuptohet vetvetiu, kur njeriu bie si prej qiellit në një vend ku nuk njeh askënd dhe në këtë rast unë e kam parë dorën e Zotit prej ditës së parë. Famullia e Shën Palit e cila kishte mbetur për tetë vite në mëshirin

e meshtarëve të huaj, sidomos të atyre që ishin të huaj krejtësisht dhe që nuk kishin njohuri as të traditës as të popullit tonë. Anëtarët e kishillit të kishës disa herë kishin bërë lutje për një meshtar shqiptar. Deri sa ka arritur kryetari i kishillit Gjekë Gjokë Sinishtaj, i cili e ka marrë punën në dorë dhe ka ecur për këtë punë, edhe kështu puna erdhë deri te intervenimi i Nuncit Apostolik në Beograd që ipeshkvia e Shkup-Prizren ta dërgojë një meshtar shqiptar. Kam arritur më 12 tetor të vitit 1989 në aeroportin e Detroitit ku më kanë pritur të gjithë anëtarët e kishillit. Ishte ditë gëzimi për besimtarët e Detroitit. Së bashku me mua ishte edhe P. Daniel Gjeçaj. Të nesërmen e patëm meshe në kishën e Sh' Palit ku i mbush kisha plotë e përplot. Kaherë nuk ishte mbushur ashtu. Që pas braktisjes së meshtarisë së Prek Damaj kisha kishte mbetë taman si një fëmijë i varfër.

Situata në komunitet ishte shumë delikate dhe nga ana politike: po në këtë kohë Partia Komuniste e Jugosllavisë kishte fuqi të madhe dhe në emigrim

cilën vetë Partia Komuniste e Jugosllavisë i solli nëpërmjet një të burgosuri nga Mali i Zi që i futi me qindra të rinj në këto probleme, sa që sot e kësaj dite i shihet shërri atij njeriu.

Ja fillova duke krasitë, por çka ishte shumë interesant, e pashë se ky popull ishte i shëndoshë dhe dëshiron shërim. Kështu që fillova të predikoja kundër vëllavrasjes, e cila së shpejti u fik. Kjo kolerë ka ditë për t'i shkatërruar për tridhjetë vite njerëzit e pafajshëm, të cilët janë detyruar t'i lënë gratë e veja e shumë fëmijë të varfër pa prindër, e shumë nëna e etër pa fëmijë të tyre të dashur.

Përpos kësaj, ia fillova luftën kundër drogës dhe kundër ndasive e përçarjeve, kështu që filloi të dalë në pah suksesi: shumë familje i ribashkova dhe u fola për rëndësinë e kurorës shenje, të cilën duhet ta ruajmë si sytë e ballit. Kështu ngadalë filluan të tregojnë interes për kishën dhe prej ditës së parë u mbush aq shumë me njerëz, sa që u pa menjëherë nevoja për parking, e as nuk kishte më vend në kishë se nuk na nxinte, edhe pse ishte

Fillova të iu bashkëngjitem demonstratave të panumërta, aq sa që edhe në Rambuje shkova me besimtarët e mi. Kështu filloi të marrë hov të madh kjo qendër edhe u pa se ma nuk ka hapësirë në këtë vend, por duhet shkruar diku tjetër. Kjo na bëri të shikojmë për një vend ku edhe fati na dërgoi në Rochester Hills e ku sot gjendet vërtet ky gjigant i rrallë edhe për vetë amerikanët. Duke qenë se kërkohej një kishë me përmasa më të mëdha, e kjo sot ka 1700 ulëse, përveç atyre që mund të rrinë në këmbë. Për Pashkë e për Krishtlindje marrin pjesë mbi pesë mijë veta. Ky objekt i pranom me kapacitetin e vet.

Në kishën e vjetër nuk kishim as një klasë, e tani i kemi gjashtë klasë, të cilat përdoren për mësimin e gjuhës shqipe si dhe për edukimin fetar. Të shtunave dhe të dielave mbushen plotë e përplotë me të rinjtë tanë. Përpara na mungonte një sallë e madhe me kuzhinë. Sot e kemi sallën për 980 veta ku mbahen dasmat, koncertet e ndryshme, siç e patëm në këtë vit Festivalin Folkloristik, të parin në Amerikë. Përpos kësaj,

tët." Më vonë na i tha këto fjalë, ka menduar se do të jetë një vend i vogël, por është befashuar këndshëm.

Sa anëtarë shënon famullia e juaj dhe a ka lëvizje të konsiderueshme të popullatës me qenë se në kohë të fundit kemi një rënie të lehtë të ekonomisë në Detroit?

Don Antoni: Deri në dy vitet e kaluara, numri i familjeve të regjistruara kishte arritur deri në 1800 familje, por fatkeqësisht rrethanat e ndryshme e sakatuan këtë komunitet shumë keq. Në këto dy vite me qindra familje i kanë nisur për në vendet kah kanë ardhur e pastaj edhe shumëkujt i është dashur të braktisin vendin për t'u fshehur nëpër vende të ndryshme të Amerikës, e një pjesë e mirë kanë kaluar në Kanada ku mundën të fitojnë lejen e qëndrimit më lehtë. Kështu që kriza ekonomike dhe ajo e emigrimit e kanë bërë të veten në komunitetin tonë. Tani momentalisht numri figuron rreth 1400 familje por përsëri janë të mjaftueshme për një komunitet të fortë.

Familja është mjerisht në krizë, por në Amerikë kjo dukuri është veçanërisht e përhapur. A mund të përshkruani situatën në përgjithësi?

Don Antoni: Përpos krizës ekonomike, mungesa e fesë në botë, bota ka marrë një rrugë pa rrugë. Kuptohet se kjo kolerë e ka kapluar tërë botën. Askush nuk mundet sot të lavdërohet me familje, kudo që ai gjendet. Mjetet e informimit siç është interneti, filmat e ndryshëm, revistat e ndryshme e kanë bërë të veten, kështu që kjo sëmundje e ka infektuar çdo njeri në botë.

Duke qenë se edhe ne jemi pjesë e kësaj bote, kuptohet se jemi infektuar shumë keq. Shkatërrimi i familjeve është tragjedia e njerëzimit. Nëse arrihet ky institucion të shkatërrohet atëherë çka do t'i mbetet botës?

Gjatë luftës së fundit në Kosovë dihet që komuniteti katolik shqiptar në Detroit ka kontribuar shumë. A mund të na përshkruani shkurtimisht dhe konkretisht këtë ndihmë ndaj bashkatdhetarëve tuaj?

Don Antoni: Kuptohet prej fillimit të gjithë e kemi përjetuar krizën e Kosovës si krizë tonën. Më kujtohet një herë një polak erdhë gjatë luftës së Kosovës e më tha: "Po i shoh ata fëmijë si hule duke bredhur maleve me pleq e të rinj, po më mbet buka në fyt. Me të vërtetë, edhe pse kemi qenë larg luftës, por e kemi ndërjet së bashku me popullin kosovar. Në vitin 1992, kur u përzu nga puna shqiptarët kemi bërë një aksion në kishë ku për një orë janë grumbulluar 64,400 s, e ato i kemi dorëzuar në bankën e Lihtenshtajnit. Kuptohet

për bukë të të varfërve, por nuk di a kanë arritur deri te goja e nevojtarit a jo?

Në vitin 1998, kur filloi flaka në Drenicë, një mbremje në kishën tonë janë bashkuar 189,000 s e pastaj ka filluar aksioni "Vendlindja thërret", ku shuma ka kaluar milionëshin. Përpos parave për luftën, kemi pasur shumë e shumë aksione për nevojat të ndryshme të famullive, qofshin ato në Shqipëri, Mal të Zi apo Kosovë. Gjithmonë kemi dhënë kontributin tonë, sa kemi pasur mundësi.

Këtë qendër e kanë vizituar shumë personalitete, si nga trojet shqiptare, por edhe jashtë. A mund të na thoni, cilat personalitete me rëndësi e vizituan?

Don Antoni: Kisha e Sh' Palit ka qenë një limë ku janë ndalur shumë anije duke filluar prej vitit 1992 me Dr. Sali Berishën, Gramos Pashkon, me Qeverinë e Ramiz Alisë, e pastaj ishin dr. Ibrahim Rugova disa herë, dr. Bujar Bukoshi, Pjetër Arbëri, Adem Demaqi, Mark Kraskiqi, Fehmi Agani, Azem Hajdari, Hashim Thaqi, Naim Maloku, Presidenti Mejdani dhe Presidenti Moisiu, si dhe shumë e shumë të tjerë.

Si qëndrojnë raportet në mes këtij komuniteti dhe kishës lokale në Detroit?

Don Antoni: Kuptohet se si famulli e arqipeshkvisë dhe si meshtar i inkadruar në këtë arqipeshkvë, duhet të jenë marrëdhëniet e mira. Kam pse të krenohem me ta dhe mund të shpreh falënderimet Kardinalit të vendit Adam Maida, i cili disa herë më ka shpëtuar prej njerëzve të këqij, të cilët janë munduar të më largojnë nga famullia e mandej kur e kanë pa se nuk mund t'ia dalin, kanë filluar të më padisin në gjyq ku më kanë akuzuar për 12 milionë, por nuk kanë fituar asnjë cent, e kjo jo vetëm një herë por katër herë. Për këtë e falënderoj nga zemra Kardinalin, i cili është treguar si babë i mirë në mbrojtjen time dhe në suportimet e kishës shqiptare. Ai na i ka huazuar gjashtë milionë s për ndërtimin e kishës sonë.

Duke ju falënderuar për intervistën tuaj, ju lut të më lejoji pyetjen e fundit që do të jetë pak provokuese: cila është e ardhmja e kësaj qendre dhe e famullitarit të saj?

Don Antoni: E ardhmja e kësaj qendre dhe e famullitarit të saj nuk dihet, por në duar të Zotit. Shpresoj se Ai ka për t'u interesuar për të ardhmen e saj, siç është interesuar deri më tani. Unë gjendem në pragun e pensionimit, tani nuk kam kurrfarë planesh, por do t'ia lëshoj një meshtar drejtimin e kishës dhe shpresoj se do t'i gjendem afër, t'i ndihmoj, aq sa mundem. (Intervistoi: don Jeton Thaqi)



Brendia e kishës gjatë kremtimit të meshe

i kishte emisarët e vet, të cilët prej kohe në kohë vinin dhe bënin propagandë duke iu thënë: nëse bëheni anëtarët e kësaj kishë, nuk do të kenë mundësi për ta vizituar vendin tuaj. Kështu kishte ra numri i besimtarëve në pesëdhjetë familje. Përpos kësaj kolere, ishte Partia komuniste enveriste nga Shqipëria, e cila po ashtu bënte propagandë të mëdha kundër fesë e sidomos kundër Nënë Terezë. Kështu që kanë qenë të njohur enveristët e Detroitit në këtë vend. Përveç këtyre dy grupeve, ishin edhe partitë tjera si Balli Kombëtar, Legaliteti...etj. Njerëzit ishin të përçarë në grupe e parti. Mirëpo a ishte situata e mirë? Mos vet! Gjatë këtyre viteve kishin hyrë armiqësi në mesin e njerëzve aq shumë, sa që ka pasur vrasje e hakmarrje, e numri i tyre arriti deri në dyqind veta që janë vra e varrosur në vendet kah kanë ardhë. Përpos këtyre anomalive, gjeta komunitetin në shkatërrim e sipër, sidomos në ndasitë e familjeve, e mos të flasim për njerëzit që merreshin me droga dhe ata që gjendeshin në burgjet e ndryshme prej kësaj kolere, të

e madhe ajo. Kisha i kishte një mijë e treqind ulëse, me gjithë atë ishte e vogël.

Don Anton, a mund të na thoni dy fjalë në lidhje me objektin e ri të ndërtuar jashtëzakonisht mirë. Çka ju shtyri që ta ndërtoni kishën dhe objektet përcjellëse me përmasa gjigante, së paku për parametrat tanë? Cila është rëndësia e këtij objekti sakral për komunitetin shqiptar katolik?

Don Antoni: Aty kah fundi i pyetjes së dytë e cekta se si filloi të rritet interesi për fe. Fillova me një ritëm të ri, me një entuziazëm të papërshkruar. I filluam disa aktivitete që deri atëherë nuk ishin pa as nuk ishin degjuar atje. Bashkimi i të rinjve për çdo ditë diele në "pizza party", hyrja pesë dollarë e piza pa pagesë, e kështu u lëshuan rinia si delet në krypë. Ky aksion vazhdoi për gjashtë vite pa ndërpre, kështu që filluam me festivalin e ri për herë të parë që deri atëherë kishin shkruar nëpër festalet jugosllave, porse tani filloi diçka e re në komunitetin tonë shqiptar.



ne shërbejmë komunitetin me dreka e darka për raste të ndryshme sipas nevojave që ka populli. Në këtë objekt kemi librarinë ku mbahen takimet e ndryshme, siç patëm Presidentin e Shqipërisë për dy herë, e sa e sa senatorë e kongresmenë që vizitojnë këtë qendër me shumë interes.

Vetë vendi posedon 29 ekers që do të thotë në masat tona dikund rreth 14 hektarë tokë me fushë të sportit dhe 600 vende për parking. Kështu që kjo vetvetiu është si një Shqipëri në miniatyrë, ku bashkon popullin tonë shqiptar pa dallim feje. Në hyrje shihet statuja e Gjergj Kastriotit, i cili dominon në parkingun e kishës si një roje e këtij vendi.

Para dy viteve ishte i thirrur senatori Tom Lantos për të marrë pjesë në një tubim për çështjen e Kosovës. Dhe kur i kanë dalë para në aeroport, ka filluar të mendojë në vete tash se po shkonte në një kishë e vogël edhe kështu me këto mendime ka ardhur deri te qendra e jonë, por kur në hyrjen e saj ka pa statujën e Gjergj Kastriotit, objektin gjigant, ka filluar të thoshte, "këta qenkan të organizuar dhe të zo-

Refleksione leximi

Universi i lirisë në një roman

(Ose madhështia e krijimit apo sakrifica e përjetimit: vështrim për romanin e Prend Buzhalës „Moisiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë” apo „Oratorium në njëzet nyja e një kontrapunkt të parrëfyer”, botoi „Rilindja” Prishtinë – 2003)

Të merresh me kritikën letrare, me studimin e veprës së profesorit, poetit, publicistit, kritikut, studiuesit të shquar letrar të Kosovës e njohur edhe në hapësirat tjera shqiptare, zotëri Prend Buzhalës, do t'i ngjante një „aventure” apo përgjegjësie morale dhe intelektuale, e cila rrezikon të përballesh dhe sfidohesh me madhështinë e detit krijues dhe njohurive të këtij shkrimtari e studiuesi të madh. I dëshmuar në të gjitha sferat e jetës si poet, prozator, publicist, shkrimtar, pedagog, atdhetar, studiues e promotor në jetën kulturore të Klinës e më gjerë, z. Buzhala pak vite pas tragjedisë së Kosovës na u paraqit me një botim të çmuar me titull „Moisiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë”, ku në të shpaloset tërë ajo rezistencë e tragjedi e luftës, si në aspektin personal, familjar dhe kolektiv, pjesëmarrës i së cilës ishte edhe vetë autori i këtij libri.

■ SHKRUAN:
VILSON CULAJ

Ngarja reale zhvendoset tek muret e një „Shpelle Asketike” dhe aty afër, tek „Shenja e një Mali”, metafora këto shumë të arritura, nëpërmes të cilave shprehet simbolikisht fuqia e brendshme e meditimt dhe e shqyrtimit në njërën anë, dhe vizioni krijues e shpirtëror, në anën tjetër. Gjithçka ndodh në jashtësi, në eksterier, në natyrë, në oratorium a në Kosovën e luftës, sepse Shtëpi e Lutjes ishte e tërë Kosova. Të duket sikur Lutja shqiptohet si në kohët e lashta biblike, në majë malesh a në vetminë kolektive e personale.

Gjatë atij rrugëtimi tragjik dhe pas debimeve kolektive të banorëve nga ana e makinerisë serbe, përbri personazhit, Moisiut, (si nofkë e luftës) e rri Boborima (edhe ky emër është përkëdhelës, i përdorur si nofkë e luftës), një si „fat i tij” i jetës dhe zëri i dytë i shpirtit që shëtit në brendinë e personazhit, që nga rinia e tij e hershme. Moisiu del edhe si personazh kompleks ideoshënues, personifikim i Njeriut të Urtë të Luftës, po edhe i Historisë në Priftë, Kohës Cezarike, Kohës shumëdimensionale, Motit shumëstresor në arkitrashëgiminë tonë shpirtërore.

Struktura komplekse e romanit

Struktura komplekse e romanit në Kohën Aktuale, Kohën e Luftës, rrefehet në 20 nyja a kapituj të përmbledhur në pjesët: Dita e Parë në Ditën e Njeriut, Tri Ditë në Ditën e Dytë, Ditët Njerëzore mbi Varrin Që Këndon, Ditët Njerëzore në Ditën e Hyjit dhe Dita e Tretë në Tri ditë. Kurse Arkikoha, Koha Shpirtërore, Koha Historike apo Koha Mitike „rrefehet” tek kapitujt: Nga rrefimet për Njeriun e Fshehtë 1, Nga kuvendimet


me Urtakun e Fshehtë 2, Nga rrefimet e Njeriut të Fshehtë 3 dhe Nga rrefimet e Njeriut të Fshehtë 4. Fijet e Kohës Subjektive, Kohës së Personazhit, Kohës Retrospektive, strukturohen te kapitujt: Nga Fletorja e Kujtimeve, Fletorja e Dëshmisë 2, Fletorja e Dëshmisë 3 dhe Nyjat e Parrëfyera. Narratori i romanit, në atë Arenë-Fushim tragjedi dhe eksodi biblik, takon edhe shumë njerëz të tjerë të pafat, të cilët i kishte përfshirë lëmshi i luftës. Duke shenjëzuar në ndërdijën e tij tërë atë tmerr e lemeri kombëtare, autori ne psikikën dhe imazhin e tij të syve dhe mendjes, kishte krijuar një „HARTË TË GJAKUT”, e cila në formë të një ditari po shënjonte copëza dhimbjeje të tragjedisë kosovare dhe dilemës mes jetës a vdekjes. I mbërthyer në „Kryqin e lirisë” që do të vinte, narratoret e autorit Buzhala meditojnë, ngushëllojnë, bisedojnë dhe u japin kurajë njerëzve të dëbuar që i kishin pranë vetes. Kurse personazhi i ngushëllonte me fjalët që vetëm një herë në jetë sillen nëpër kokë. „Mos mbylli në kazamatet e shpirtit, këputni grillat që lëshojnë hije mbi horizontin e padukshëm të vetvetes. Bashkëvuajtësit e tij e kishin quajtur atë se bashku me Boborimën e tij „Njerëz të padukshëm” apo „Njerëz të kristaltë”, dy medalje të shpirtit njerëzor; Urtia dhe droja në njërin e jetës tejdrukshmëria apo bardhësia e shpirtit, në anën tjetër. Jo ajo drojë e dhënies së jetës për liri, por droja nga kurthet e jetës pikërisht nga i afërmi dhe bashkëpunëtorët, e bashkëvuajtësit, por jo edhe tejdrukshmëri e tepërt që i rrezikon vlerat e shpirtit në anën tjetër.

Modelet e personazheve

Në këto dy dimensionet autori shënjon copëza biblike në ditarin e tij të luftës si: „O Zot, edhe foshnjat u përzier në luftë...”, „E

harrova fotografinë e babës, për një fije floku shpëtova”, „Rrugës pasbë njerëz të urarë, këso lufte s'mbahet men”, „O Zot, mallkue kofshin”, etj. I rrethuar nga këta zëra që villnin dhimbje e tragjedi familjare, autori këtë gjendje e ndien si shenjë e kthesës kolektive të ndërdijës, pastrim nga pengesat e brendshme. Gjatë rrugës së Golgotës që zgjat bregut të lumit, të cilin e quanin „Lumi i Vajit”, Kosova për autorin ishte shndërruar në një „ORATORIO”, ku luteshin të gjitha pa dallim me shikim nga qielli. Brenda kësaj thirrjeje për liri, njerëzit i kishin ndryshuar emrat, si „Të padukshmit”, „Grigjë, Boborimë, Mjellmë, apo Drenushë”, si quhet personazhja e dytë. Veçse njëri prej tyre quhej Moisi. Ai Moisiu, i cili e kishte zjarrin e lirisë dhe atdhedashurisë brenda vetes qysh se ishte i ri, i cili kishte vendosur të udhëtonte me Qerren e Zjarrtë të tragjedisë së Kosovës. Është si ajo qerrja biblike që personifikon hyjnorën dhe lirinë. I zhytur në thellësitë e shpirtit, autori mediton dhe shqyrton situata historike. Ai mediton për zanat, orët, ashtin e lidhur një e vakëfët. Kujton kohën kozmike të Shën Pjetrit (një çast i Zotit është njëmijë vjet tokësore), personazhi simbolikisht e quan „Kalendarin e oqeanit të dritës”. Po në këtë gjendje ku kërcënohej jeta, autori tenton ta bëjë dallimin në mes të Urtakut dhe Shenjtorit, si dhe jetës paralele në anën tjetër, por qëllim i tij themelor ishte njohja e vetvetes. Vendosija e një Plaku të Urtë në qendër të rrëfimeve historike, (ndryshe personazhi quhet Njeriu i Fshehtë, aty ku vendoset plani i tretë kohor a niveli i tretë narrativ, shtrësor e kompozional), nuk është krejt i paqëllimshëm, ku përmes tij shpalosen figura dhe deformime të ndryshme që nga koha e Turqisë e këndje. Te e fundit, a nuk ligjëron si zë ndërdijeje e ndërgjegjeje te secili prej nesh nga një Njeri i Fshehtë?

Një si personazh i zbulësave psikologjike personale e kolektive? Plaku është një „instrument vocalis” në imagjinatën e autorit; ai shpalos shtrësimet historike që nga Koha e Kryqëzimit të Krishtit e deri në ditët e sotme. Autori këtë çast kozmik e quan „libri i larjes së borxheve historike” apo ligji i Karmës Budiste. Borchhi i shkakut dhe pasojës qoftë ai personal apo kolektiv. Autori klith për mungesën e „hartës së identitetit” apo ringjalljes, mu për shkakun e mungesës së shpirtit joqlirues nga robëria e mëkatit. Zhytur thellë në ankthin e pasigurisë personale e kolektive, narratori mediton se si të shpëtohej ky popull. Ai ngushëllimin e gjen tek „Dora e Hyjit të gjallë”, i cili plandoset për amshim nga diktatura, nga terrori, a nga perandori gjaku. Këtu z. Buzhala shtie edhe forcën e idesë/ve dhe të paqes, model se si e keqja mund të luftohet përmes së mirës dhe së drejtës- dashurisë dhe vetëfijimit. Ai shprehet: „Ku ka lëvizje çlirimtare apo zhvillim të shoqërisë që mund të funksionojë pa dijen”. Autori arrin në përfundim se vetëm qeniet përsosshmërisht të zhvilluara, dinë të bëjnë luftë paqësore”. Në qendër të këtyre rrëfimeve është edhe një djalosh i quajtur Studenti (nofkë e luftës), i cili e kishte lënë luksin e perëndimit dhe kishte ardhur për të luftuar për Kosovën dhe lirinë e saj. Ai kishte furnizuar shumë shokë me armatim. Kishte lënë edhe të fejuarën në perëndim, vetëm që t'i përgjigjej zërit të atdheut. Në anën tjetër, na paraq-



Prof. Prend Buzhala

itet figura e Shurdhanit (nofkë e luftës, po ashtu), i cili lufton së bashku me Studentin, ku ky i pari edhe plagoset në luftë. Pas betejës gjendja e të zhvendosurve bëhet edhe më e vështirë. Numri i tyre ishte diku 15.000 mijë njerëz. Të etur dhe të uritur e pa gjumë, pritnin të zhvendoseshin duke bërë lutje parajsore në muzgun tragjik që binte mbi kokat e tyre. Ata luteshin për të tanishmen e tyre, por më shumë për të nesërmen mëngjesore. Në atë përballje jete, krijesa njeri përbri instinktit të Tanatosit përballlet edhe me atë të dashurisë, dashuri që e vraste ankthin dhe pasigurinë e kohës dhe jetës. Në errësirë nate protagonistit sheh në dritën e tij të vetme. Ai ndien vezullimin e syve të Saj, edhe pse ishte errësirë nate, sy që i kishte parë dikur në rininë e hershme. Ai ushqehet me mall-

in e saj të dikurshëm, ashtu si po i jepnin kuptim jetës së tyre mu në zjarrin e luftës, mbasi që të dytë ishin luftëtarë e këtu, kryeprogonistë të romanit. Në heshtje ia lexon edhe shenjat e zemrës. Zoti ia kishte sjellë në atë vend mallëngjimin e tij që ai të ushqehet e dehet nga afërsia e saj. Ishte këpër të gjitha nivelet tersktore të romanit ligjërojnë, vetëligjërojnë, paraqiten, figurohen, strukturohen edhe personazhe të tjerë të panumërt, që identifikojnë një ide, kohë, motiv, themë-dilemë, akt tragjedi... a shumë-sësinë komplekse të botës njerëzore.

Ballafaqimet narrative

I zhytur në peshën e flakëve dhe dhembjes rinore, protagonistin arrin t'i japë një të puthur mallit të tij të kamotshëm, jo puthje buzësh e ndezje trupi, por buze e puthje shpirti që gjurmët i lënë thellë në horizontet e mallit të përvëlur - shpirtit. Shpirti i fejuar me dhimbjen dhe kohën që nuk ecën, do ta kishim quajtur atë çast ballafaqimi. Atë harmoni shpirti e prishin granatat armike dhe largësia do t'ia linte kokën dhe sytë e tyre pas për mallin që shuhej në heshtje. I vetmuar në shoqërinë e qiellit të hapur, personazhi shpalon edhe kohën e dikurshme me Boborimën, që i ruante berret në „Malin e sertë“, mal të cilit nuk guxoi kurrë t'i afrohej nga frika e bukurisë së saj, dhe tradita e kohës. Mali paraqitet jo vetëm si skenë ngjarjesh gjatë luftës, po edhe gjatë historisë, paraqitet edhe si altar historik, altar liridashës e mitik e biblik. Ngushtëllimin personazhi e gjen në falën që e kishte zbuluar nata e qetë, „çasti i kalon 1000 vjet lumturi“. Ai kujton me mall këngën e Grigjës së saj, e cila shpesh e linte plot mall të plagosur në fushë. I dalur në një shteg tjetër të dritës, rëfimtari ynë shqyrton për Apokalipsin, sadistët e luftës, qorton ata njerëz që dikur nuk besonin në ekzistimin e Ushtrisë Çlirimtare, kurse sot po e shihnin me sytë e tyre luftën, sakrificën dhe lavdin e tyre. Pas shumë ditë vuajtjeje dhe ulur në një shpat mali, protagonistin mundohet t'i harrojë dhimbjet e pikëllimet e tij për rënien e luftëtarëve në kufij, kujton vuajtjet e grave, pleqve e fëmijëve pa bukë, por mendjen ia trazon rasti i vrasjes së një luftëtarit të lirisë, i cili kishte ardhur nga Danimarka për ta ndihmuar atdheun e tij. I kujtohej letra e lënë amanet për t'ia dërguar nënës dhe nuses në Tiranë dhe djalit, Gonit. Varrimin e tij e kishin bërë në muzugun e natës një plak dhe një bari. Gjatë atij shtegu që autori e kishte quajtur „Bota e Ferrit“, ata kishin takuar njerëz të vrarë, të masakruar, të pa koka, me thikë ngulur në gjoks, fëmijë të vrarë në krahorin e nënës e plot tmerre tjera. Në mbërmenje e kishin varrosur

pranë ca lisave dhe ia kishin vënë një shenjë identifikimi. Mu në atë mbërmenje do të fillonte edhe „lufta“ e vetmuar e atij njeriu që ishte mësuar që betejat t'i fitonte vetëm. Këtu qëndronte edhe kufiri shpirtëror në mes tyre... Ballafaqimet narrative si: guri, muri i kishës, shtëpia me plasa etj marrin karakter simbolik, të cilat njëherësh të çojnë tek ëndrra e „Atdheut të plasaritur dhe prerë në kohe“. Rëfimet përmes gojës së një plaku për ujin, lagështinë, minjtë, gjarpurin japin shprehjen destruktive të disa njerëzve, të cilët mundohen t'ia sjellin të keqen Kosovës dhe fatit të saj. Marrja dhe shtjellimi i figurës së Gjarprit si Totem Ilir, paraqet të dy anët e medaljes së njeriut, ku në brendinë e tij fshihen të mirat në njërin anë dhe ligësitë e komplotet në anën tjetër, karshi qëllimit për lirinë e Kosovës. Tek ai gjarpër fshihet mbrojtja e njerëzve, kurse në anën tjetër na dalin intrigat, komplotet, dëshirat e fshehta karrierte, sa që autori arrin t'i quajë „Të mbështjellë me këmishë Engjëlli mu si Satana“. Përmes medimitit autori shpalos herezitë e disa njerëzve të kohës, të cilët kinse luftën dhe dhënien e jetës për te, e marrin si jo fort të rëndësishme. Ai, në anën tjetër, merr shembuj si të Pjetër Bogdanit, Budit e Gjeçovit që luftuan kundër robërisë turke e sllave. Kthimi në kohë dhe përkujtimi i figurave si Moisiut Biblik, dhe rastin e viçit të bronz-të dhe gjarpurit në dru, është një thirrje se si njeriu i sotëm duhet të ruhet nga idhujtaria e rrejshme e njerëzve të cilët rrejshëm dhe për qëllime të tyre, me pare, - paraqesin qëllimin personal se sa atë kombëtar. Autori si paradigmë dhe si vlerë e këtij fenomeni dhe ideali të përbotshëm, e merr figurën e lavdishme të Gjergj Kastriotit, të cilit ia atribuon të gjitha meritat dhe vlerat historike që e kanë shoqëruar popullin tonë në shekuj. Krijuesi Buzhala hedh paradoksin në mes të atyre njerëzve, të cilët nuk i njohin gjurmët e identitetit kombëtar. Njerëz që nuk mund të kenë as qasje shpirtërore. „Çka dinë çka është altari e lutja -lutësorja e kambana“, ngrit zërin e falës autori. Ku mund ta kuptojnë çastin e njëmijë vjetëve në një çast. Ky është guri krijues, thotë naratorin, i cili e vret vdekjen brenda ligjeve të saj obskurantiste. Guri po humb nga themelet e tij të shenjtërueshme, njeriu po humb brenda themeleve të tij të frymës -shpirtit. Ai kërkon gurin e amshimit në zhurmën dhe rrëmujën e kohës. Autori i çmon gurët e mureve të shpirtit që ndërtohen dhe fisnikërohen nga brenda dhe

“ Autori, edhe pse i vetëdijshëm se vajtimin tonë kombëtar dikur do ta zbehë – shuajë koha, ai kërkon njeriun e arsyeshëm „shenjë për ardhmërinë e pas luftës“. Ai kërkon që të bëhemi mburojë e ushtrisë së drejtësisë, arkë në oqeanin e njohjes, diell i mirësisë dhe shtyllë e së pamposhturës. Autori shpirtgjerë nuk kërkon që të bëjmë të njëjtën gjë, siç kanë bërë armiqtë tanë me ne, por në momente urrejtje e krize, ta kemi zemrën e qetë dhe të pastër, kur të na nxitë krimi a barbaria. ”



firit dhe barbarinë serbe që ishte ushtruar mbi ta. Autori shtron pyetjen: Vallë, a mundet njeriu të mbijetojë në luftë pa luftë – pa Zotin apo shpresën. Ai jep vetë përgjigjen: jo. A duhet njeriu të jetojë duke urryer gjithmonë. Jo, thotë autori. Buzhala pikëllimin e merr si shenjë dhe dhuratë të shpirtit, por prapë shpreson në drejtësinë, mos atë të njeriut, të Hyjit të gjallë po se po.

Shpirti-Mbret

Autori, edhe pse i vetëdijshëm se vajtimin tonë kombëtar dikur do ta zbehë – shuajë koha, ai kërkon njeriun e arsyeshëm „shenjë për ardhmërinë e pas luftës“. Ai kërkon që të bëhemi mburojë e ushtrisë së drejtësisë, arkë në oqeanin e njohjes, diell i mirësisë dhe shtyllë e së pamposhturës. Autori shpirtgjerë nuk kërkon që të bëjmë të njëjtën gjë, siç kanë bërë armiqtë tanë me ne, por në momente urrejtje e krize, ta kemi zemrën e qetë dhe të pastër, kur të na nxitë krimi a barbaria. Autori Buzhala kërkon që të rimë brenda asaj qetësie, brenda atij ekuilibrit, përndryshe nuk mund të kryhet shumë punë në universin tonë që gjendet brenda nesh. Autori kërkon që brenda çdo ndjenje trupi-instikti, të mbizotërojë „shpirti mbret“ e jo e jo mendja e trupi i prishur ta dëbojë shpirtin nga banesa e tij. Përgjatë shtetisë së shpirtit, autori sodit në kohë dhe hapësirë, ku i shfaqen figura njerëzish me shpatë, të cilët vrasin bashkëluftëtarin dhe bashkëpunëtorin e vet, një gjendje kjo që i ka ndodhur çdo njeriu me ideale të forta qoftë kombëtare, fetare apo intelektuale. Ndër ta edhe protagonistin i këtij libri. Edhe pse në këso gjendjeje stoiku dhe intelektual ynë rri denjësisht pranë „Harkut të triumfit“ dhe e pret ngadhënjimin në jetë që e mira të dominojë mbi të keqen ngjizur në përvojën dhe shtegun e jetës. Edhe kjo gjendje, e cila buron nga frymë hyjnore, për autorin është syrgjynosja për atdheun, harmonia e kozmosit, shpërblim parajsor dhe njerëzor. Dhe pas gjithë këtij udhëtimi parajsor dhe kalvari personal dhe realizimit të idealit kombëtar e intelektual, njeriu disi vetë kërkon takimin në Hyjin e gjallë, takim i cili i ngjan siç shprehet autori, në një „pikë uji në barin e lagur nga shiu i lotit dhe djersës në livadhin pa mbarim“. Ky momentum katarzues i përngjan edhe përbushjes së ligjit mesianik „se zemra e çdo ligji në këtë botë është falja“. Autori është i vetëdijshëm se një ditë do të kthehet në shtëpinë e Atit qiellor, por pa i thënë të gjitha. E tëra mund të thuhet veç në kujtesën e brezave të ardhshëm. Aty është mu kjo shenjë plaje, të cilën e përjetoi edhe autori në hojet dhe labirintet e shpirtit të tij.

Bota si libër

(Anton Berishaj, "Retorika dhe letrarësia - Teksti i Bogdanit" - Buzuku, Prishtinë 2004)

■ SHKRUAN:
Ndue UKAJ

Korpusi letrar i fillimeve të letërsisë shqipe, i përkufizuar si letërsi e vjetër shqipe, në komunitetin e kritikës letrare shqipe, asnjëherë nuk ka zënë vendin e merituar. Mbase kjo letërsi, duke pasur për tematikë dimensionin religjioz në njërin anë, dhe, në anën tjetër, duke u formësuar në shtratin e poetikës së letërsisë perëndimore, në kritikën shqipe ka marr cilësime të gjithfarshme, por më së paku vlerësime estetike-letrare. Në njëfarë mënyre, ky korpus letrar (Buzuku, Budi, Bogdani, Variboba, dhe ndonjë tjetër) u bë për kritikën shqipe "Thembra e Akilit", me të cilën në mënyrë të veçantë u shërbye soc-realizimi në art dhe letërsi, për ta zhvlerësuar këtë korpus letrar, i cili paraqet shtrësimin bazik për gjithë letërsinë e mëvonshme shqipe me autorët e mëdhenj (Mjeda, Kuteli, Koliqi, Fisha, Poradeci, Camaj, Pashku etj.). Së këndejmi, kualifikimet e ndryshme për këtë korpus letrar-estetik, në raste të shumta fare nuk përkojnë me funksionin e letërsisë. Madje duke harruar se vepra fundamentale të artit botëror janë ndërtuar mbi hipotekstin biblik (Shën Augustini, Milioni, Dante, Xhojsi, Elioti, Kafka, etj.), ngase Bibla për letërsinë Perëndimore, ku bën pjesë edhe letërsia shqiptare mbetet teksti qendror (Northrep Frajti). Ndikimet e Biblës në Letërsi, dijetari i madh i letërsisë Fraji i sheh të vlerat universale të biblës, dhe të dimensionit i saj letrar. Asnjë vepër nuk mund të ketë ndikim në letërsi pa pasur vlera letrare, mbron mendimin dijetari Fraji. Kjo cilësi e Biblës ka bërë që ndikimi i saj në letërsinë perëndimore të jetë predominantë. Një fakt të këtillë e kemi tashmë edhe në letërsinë shqiptare, ngase ndikimi i Biblës përgjatë pesë shekujve të gjallimit të letërsisë shqipe, ka qenë superior, dhe me efekte të rëndësishme, për poetikën letrare. Mbase modeli i ligërimit biblik në letërsinë shqipe është bërë shkollë letrare

specifike dhe me ndikime edhe në nivel të kodeve tematike, edhe të diskursit. Pretendimet e ndryshme, për ta parë këtë letërsi me ekuivokë, të dalura në forma të ndryshme, se ky korpus "është

Qysh në titull të librit, Anton Berishaj, na sugjeron natyrën e qasjes së studimit të tij: teksti i Bogdanit, shtrohet në raport të letrarësisë (koncepti i Roman Jakobsonit), i cili shkruan: "objekt i

është të hetohet strategjia bazike retorike/semiotike e tekstit, funksionimit të tij si tërësi në tekstin e Bogdanit. Nëse do t'i referoheshim teoricienit dhe mendimtarit të letërsisë Zherar

onet e veçanta. Antoni merr në shqyrtim probleme specifike të letërsisë në planin universal, për t'i ridimensionuar pastaj teorinë, kërkimet në atë kontekstual (kulturën shqiptare dhe realitetin e studimeve), dhe në fund për t'i funksionalizuar tek teksti i Bogdanit, "Çeta e Profetëve", tekst themelor i formimit të asaj që autori e koncepton si kulturë tekstuale shqiptare, analizuar në kontekstin e poetikës mesjetare.

Studimi i Antonit i formuar përmes një aparature të perfeksionuar teorike-kritike, me referenca relevante, pak ose aspak të njohura në komunitetin e teoricienëve dhe studiuesve në kontekstin tonë letrar, thellon diskutimet me ide, e qasje tejet interesante edhe për korpusin e letërsisë së vjetër shqipe, veçanërisht për letërsinë e Bogdanit, duke bërë një analizë kooperative, me poetikën e shkrimit letrar mesjetar (qasje kjo që ka munguar), dhe në një kontekst tjetër, në kontekst të kulturës nacionale, për të shqyrtuar letrarësinë e këtij korpusi letrar, si, dhe në të njëjtën kohë, për të sfiduar mendimet sterotipe për këtë korpus letrar, të cilin kritika letrare edhe pse e pranon si letërsi, nuk ia jep asnjëherë këtë status. Së këndejmi Antoni, përmes qasjes së interpretimeve retorike, duke analizuar korpusin letrar të letërsisë së vjetër, shtron nevojën e theksuar për të parë literaritetin, pastaj shqyrtton autorët dhe korpusin letrar në tërësi, të përkufizuar përmes formalimit të qëlluar, Kulturë tekstuale shqiptare, e cila në studimet u referohet autorëve (Buzuku, Budi dhe Bogdani).

Intenca e qasjes së studimit të Antonit, është si shkruan ai të: "ofrojë një model shpjegues dhe interpretues të logjikës së funksionimit të tekstit të tij". Gjithnjë duke e vënë në kontekst të poetikës së kohës.

Libri ndahet në katër kapituj, të cilët ndahen në nënkapituj: 1. Semiotika dhe fictio Rethorica,

“ Intenca e qasjes së studimit të Antonit, është si shkruan ai të: ”ofrojë një model shpjegues dhe interpretues të logjikës së funksionimit të tekstit të tij”. Gjithnjë duke e vënë në kontekst të poetikës së kohës. ”

art, dhe nuk është art", se këta libra "janë tekste me rëndësi gjuhësore, por jo letrare", pastaj se këto tekste "janë tekste religjioze të krishtera", kanë sjellur një konfuzion letrar për dy shekuj të letërsisë shqipe. Për të hequr këtë vello, me studimet e tyre kanë kontribuar Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Engjëll Sedaj, Stefan Çapaliku, dhe shumë të tjerë. Ndërsa në kulturën letrare shqipe, respektivisht kritikën shqipe, Anton Berishaj, profesor i letërsisë së vjetër shqipe pranë Fakultetit Filologjik, ka bërë përpjekjen më serioze, dhe njëherit më integruese në studimin e këtij korpusi letrar, por sidomos për ta interpretuar letrarësinë e tekstit "Çeta e Profetëve" të Pjetër Bogdanit, si teksti fundamental i letërsisë shqipe të shekujve XVI-deri në shek XIX. Njëherit, studiuesi Berishaj jep modelin specifik të interpretimit, edhe për gjithë letërsinë shqiptare.

Studiuesi dhe teoricieni i letërsisë Anton Berishaj në studimin "Retorika dhe letrarësia - Teksti i Bogdanit", realizon një punë sistematike hulumtuese.

shkencës letrare nuk është letërsia, por letrarësia, domethënë ajo çka e bën një vepër të dhënë vepër letrare; dhe, në anën tjetër me retorikën, e cila kundrohet si poetikë, nga fakti, se qysh prej antikitetit, retorika, përveç se kishte funksion fundamental në formësimet poetike (artistike), në perspektivën e zhvillimeve letrare, siç thotë Barit, është bërë një kod i madh letrar, ku artet poetike janë arte retorike, ku retorët e mëdhenj janë poetët. Nga kjo qasje, nisat hulumtimi i Berishajt, për të hetuar shkallën e letrarësisë (nivelelin estetik të "Çetës së Profetëve" të Pjetër Bogdanit) në kontekstin e retorikës, përmes një relacioni dijesh, të cilat funksionojnë në rrjet. Studimi i Berishajt asimilon teori të shumta për artin letrar. Rrjedhimisht, për të qenë sa më argumentues, autori problemet teorike-kritike i zhvendos në prizëm të kohës së shkrimit të tekstit të Bogdanit, dhe në planin tjetër në prizëm të perspektivës së hapjes së studimeve letrare.

Siç shprehet autori i studimit, intencë themelore e kësaj qasje

Zhenet, se: "shkrimtari hulumton universin, kritikë hulumton letërsinë, do të thotë universin e shenjave", dhe këtë mendim ta aplikojmë tek qasja e Antonit, shohim qartë se autori nëpërmjet teorie të specializuara heton universin e shenjave letrare tek letërsia e Bogdanit, te teksti "Çeta e Profetëve", te mënyra e funksionimit të tekstit të tij, shenja këto, që i sheh në rrjet; relacion me kode letrare, të cilat formësojnë dhe konsistitujnë poetikën e Bogdanit, shumësinë e domethënies që prodhojnë kodet letrare, shenjat, diskurset dhe simbolet, si elemente bazike të konstruktimit të këtij teksti letrar.

Libri i tij, "Retorika dhe Letrarësia - Teksti i Bogdanit", është sintezë e kërkimeve teorike-kritike karshi tekstit të autorit predominant në letërsinë shqiptare të shekujve XVI-XVII, Pjetër Bogdanit, realizuar përmes një qasje, e cila "thithë" shumë dije letrare, referencat që pasurojnë studimin në fjalë. Studimi nisat nga premisa e përgjithshme, për të rezultuar tek konkluzi-

2. Kultura retorike dhe letërsia e vjetër shqiptare, 3. Teksti i Bogdanit dhe 'Makina retorike', 4. Retorika dhe letrarësia.

Në kapitullin e parë, studiuesi Anton Berishaj, jep një përkufizim të studimit, përmes tre termave bazik: Kodit, tekstit, dhe retorikës, të cilat i vënë në relacion me letrarësinë e Bogdanit. Në këtë kapitull, autori interpreton shkathhtë kuptimet e termave esencialë, sikur këta termat e përmendur më lart, të cilët mbulojnë domethënie polisemantike në teoritë letrare. Për të shpallur synimin e shqyrtimit të tekstit të Bogdanit në prizëm të kodit retorik, që në një kontekst tjetër, njëh konceptonin e interpretimit të zhanrit dhe kuptimit të figurave retorike, apo kodit metaforik, si thotë studiuesi, gjithnjë në raport të fuqishëm të kërkimeve poetike/retorike mesjetare dhe dijës semiotike, e cila interpreton shenjat e tekstit letrar.

Në kapitullin e dytë, Anton Berishaj merr në shqyrtim kontekstin kulturor dhe letërsinë e vjetër shqipe. Këtë korpus letrar, autori e përkufizon brenda teksteve të autorëve prej Buzukut deri tek Bogdani. Më tej, përmes një delli polemizues, autori kërkon që këtij korpusi letrar të mos i mohohet letrariteti, edhe atëherë kur i pohohet. Së këndejmi edhe përkufizimet e shumta për këtë korpus letrar i shoh të pa argumentuara, dhe me parashenja vlerësuese negative. Sidomos kur kjo materie letrare përkufizohet me një "rëndësi gjuhësore", pastaj "libra fetar", "libra religjioz", këto vlerësime sipas autorit të studimit janë bërë me parashenja vlerësuese negative, jo letrare dhe në kundërshtim me poetikën e kohës. Të gjitha

këto, kanë penguar kuptimin e mirëfilltë të këtij korpusi letrar, ngase "nuk është bërë përpjekje serioze për ta hulumtuar në mënyrë sistematike sistemin zhanror të letërsisë biblike shqiptare, realitetin egzistues shqiptar", ngase i gjithë korpusi letrar, elementet bazike i ka në



raporte interletrare e interdiskursive me kodet biblike, si dhe tekstet biblike përgjithësisht. Së këndejmi, autori thekson se edhe konteksti i përgjithshëm kulturor dominohej nga modeli i "retorikës religjioze", e cila formëson tërë jetën shqiptare të kohës. Dhe rrjedhimisht edhe kulturën e artin.

Andaj autori e shoh të domosdoshme që brenda komunitetit të studimeve shqiptare të shtrohet për diskutim qasja e hulumtimit të poetikave mesjetare, në kontekstin e këtij korpusi letrar, me qëndrime të argumentuara.

Ndërsa në kapitullin "Teksti i Bogdanit dhe 'Makina retorike'", me nëntitullin 'Retorika e zhanrit', studiuesi merr në shqyrtim sistemin zhanror të retorikës mesjetare, të ndarë në tri pjesë: 1. gramatika e perceptimit (nor-

mative) ose retorika e shkrimit të vargjeve, 2. arti i shkrimit të letrave, 3. arti i predikimit. Në këtë kontekst, autori predikimin/ligjëratën e definon si zhanër historik dhe zhanër teorik. Gjitha këto diskurse japin parashenjë bazike të ndërtimit dhe funksionimit semantik të tekstit të



Bogdanit: teksti i tij ka referencë në gjitha nivelet e strukturimit, kodin biblik. Më tej, autori jep një shpjegim mjaft të vlefshëm, domethënës për zhanrin e predikimit, si praktikë e shkrimit letrar, me rol funksional në tekstin e Bogdanit. Me qëllim që të zhvillojë strategjinë e hulumtimit të mënyrës së funksionimit të Bogdanit, autori shton për diskutim topikën, duke shkruar se: "teksti i Bogdanit strukturohet si rrjet taposësh, temash, mjetesh stilistike 'petrifikuara' motivesh të tipizuara, figurash, klisesh, karakteristike për letërsinë biblike dhe atë mesjetare". Më tej autori definon një specifikë të topikës bogdaniane, të konceptuar si modestia e afektuar. Për të theksuar si topikën më interesante atë që e koncepton si bota e mbrapsht, parimin themelor të

së cilës është renditja e gjërave të pamundshme.

Me qëllim që të shtrojë intencën e kërkimeve letrare në tekstin e Bogdanit, në përkufizimin "simbolizimi universal: semioza e pakufizuar- bota si libër: libri si botë", studiuesi Berishaj konstaton se topisi kryesor në tekstin e Bogdanit është bota si libër.

Ndërkaq përmes një analize thelbësore, Anton shqyrtton "doktrinën mbi katër kuptimet dhe konsekuencën e saj", e përkufizohet dhe shtrohet në kontekst me poetikën mesjetare, veçanërisht doktrinën e cila ndërlidhet me shkrimin e shenjtë dhe vërtetësinë


e saj. Këtë konsekuencë e ruan fuqishëm teksti i Bogdanit. Më tej, qasja e studimit të Anton Berishaj, thellohet në "kompozicionin e bazuar te numrat", i cili dimensionon rolin funksional që shtreson "Çeta e Profetëve" që nga ndarja e veprës në dy pjesë. Pastaj numri katër, si dhe numrit gjashtë, të cilët konstituojnë kodin simbolik të tekstit të Bogdanit. Ndërsa në vijim të librit, studiuesi interpreton "rrjetin intertekstual", e cila qasje analizon tekstin në tekst, gjitha këto në këndvështrim të kuptimit të konceptit të intertekstit. Në këtë këndvështrim, teksti i Bogdanit i referohet diskurseve që rezultojnë nga kultura religjioze, biblike dhe filozofike. Në këtë kontekst, autori thotë se "Çeta e Profetëve" është hipertekst le-

trar. Rrjedhimisht, përcaktohet karakteri polisemantik i tekstit të Bogdanit. Për të konkluduar se teksti i Bogdanit në procesin e gjenerimit të kuptimeve merr funksionin semiotik, të modeluar përmes mitesh, kodesh e diskursesh letrare, të gjitha këto në një instancë tjetër nëpërmjet kodit simbolik, i cili fuqizon statusin e tekstit letrar të Bogdanit.

Në këtë krizë të leximit të letërsisë shqipe, me një parashenjë më paragjyquese për korpusin letrar të letërsisë së vjetër shqipe, në leximin dhe interpretimin real të korpusit letrar, libri i Anton Berishaj paraqet një model me rëndësi për gjithë kulturën letrare shqiptare, dhe kritikën shqiptare, për t'ia dhënë asaj një dimension më profesional, më të racionalizuar, dhe në interaksion me zhvillimet teorike/kritike në kritikën perëndimore, të cilën studiuesi Berishaj e njeh në shkallë të lartë.

Përmes këtij studimi, Anton Berishaj na ka argumentuar në mënyrë shumë të analizuar, atë që Zheneti e thekson atëherë kur vënë në raport shkrimtarin me kritikun: "Ajo që është shenjë te shkrimtari, (vepra) bëhet kuptim te kritikun (meqë është objekt i ligjëratës kritike) dhe, në anën tjetër ç'është kuptim te shkrimtari (vizioni i tij për botën) bëhet shenjë te kritikun, si temë dhe simbol i njëfarë natyre letrare".

Anton Berishaj më mirë se çdo kush në komunitetin e studiuesve shqiptarë ka analizuar tekstin e Bogdanit në raport me retorikën dhe poetikën mesjetare, për të nxjerrë konkluzione të qëndrueshme dhe shumë të vlefshme edhe për gjithë korpusin e letërsisë shqiptare. Një qëllim dhe një punë e arritur.



Muzika dhe këndimi liturgjik në Kishë

Muzika e shenjtë do të jetë më e shenjtë, nëse ajo lidhet ngushtë me aktet liturgjike, qoftë kur ajo më këndshëm e shpreh lutjen, qoftë kur nxit bashkimin e shpirtërave, qoftë kur ritet e shenjtja i pasuron me më shumë solemnitet.

■ SHKRUAN:
Don Agim QERKINI

Një bashkëkohënik i Schönbergut, Webern, shtron pyetjen: çka është muzika? Ai vetë jep kështu përgjigjen: Muzika është gjuhë, mjet komunikimi. Me këtë përgjigje pajtohem të gjithë, dhe, vërtet, muzika e përcjell jetën e njeriut që prej fillimit. Këtë fakt e dëshmojnë shumë dokumente historike, për më tepër e hasim edhe në faqet e para të Shkrimit të Shenjtë. Fuqia e muzikës nuk mbështetet vetëm në bukurinë dhe artin e vet. Ajo është fuqi shpirtërore, e cila më së miri shpreh dhe njëherësh ndikon në disponimin e njeriut. Bibla na jep shumë raste që lidhen me muzikën, e cila ndikon në gjendjen e individit apo të bashkësisë, duke filluar nga BV me Moisiun, i cili me himne falënderimi i drejtohet Zotit që e liron nga skllavëria e Egjiptit, pastaj përmes psalmeve të Davidit e deri te këndimi i të krishterëve të parë të cilët me himne, psalme e këngë të përsëritshme i këndojnë lavd e nderë Zotit. Ndër tjera, edhe këto fakte na flasin për arsyet pse njerëzit e kanë përdorë muzikën edhe në shprehjen e ndjenjave të tyre religjioze.

Kënga me karakter fetar ka ndikuar edhe në kthimin e Shën Augustinit (+430), të cilën e kishte dëgjuar në Katedralen e Milanos, apo në kthimin e shkrimtarit francez, nobelistit Paul Claudel (1868-1955), i cili e shijonte muzikën në katedralen e Parisit. Pra, muzika na përcjell kur i lutemi Zotit, kur jemi në pikëllim na e lehtëson dhimbjen, na përcjell në momente gëzimi, në festa të ndryshme, muzika është pjesë e jetës.

Përgjithësisht, janë shumë dokumente që kanë ndikuar në zhvillimin dhe reformën e muzikës kishtare, ndër të cilët po përmendi dokumentin më të rëndësishëm para Koncilit: *Motu proprio* i Papës Piu X, *Tra le sollecitudini* (Inter pastoralis officii, më 22 nëntor 1903), dokument ky me të cilin fillon reforma e muzikës kishtare në shek. XX. Dokumenti tjetër është Kushtetuta apostolike e Papës Piu XI mbi liturgjinë, këndimin gregorian dhe muzikën e shenjtë Di-

vini cultus sanctitatem (20 dhjetor 1928). Pastaj, enciklikat e Papës Piu XII, mbi liturgjinë *Mediator Dei et hominum* (20 nëntor 1947) dhe për muzikën e shenjtë *Musicae sacrae disciplina* (25 dhjetor 1955). Vlen të përmendet edhe dokumenti me titull: Udhëzime për muzikën e shenjtë dhe liturgjinë e shenjtë në kuptimin e enciklikës së Papës Piu XII, botuar më 3 shtator 1958, i cili spjegon kapitujt kryesor të këtyre enciklikave.

Roli i muzikës kishtare në liturgji

Që të kemi mundësi ta caktojmë vendin dhe rolin e muzikës kishtare në liturgji, është me rëndësi së pari të shohim kuptimin e vetë liturgjisë në jetën e Kishës. Liturgjia është kulmi drejt së cilit është e orientuar e gjithë veprimtaria e Kishës. Në liturgji, përpos që merret pjesë në aspektin e brendshëm shpirtëror, në të po ashtu pjesëmarrja përbëhet edhe prej lëvizjeve, qëndrimit të trupit, përgjigjeve dhe këndimit. Një prej pjesëmarrjeve më aktive është pikërisht këndimi. Duhet thënë se liturgjia nuk e ka shpikur këndimin, por ajo e merr atë nga realiteti i përgjithshëm njerëzor duke përdorë fuqinë e saj.

Në natyrën e liturgjisë qëndron fakti që ajo do ta përfshijë tërësisht njeriun: me shpalljen e Fjalës liturgjia pasuron mendjen e tij, me simbolikën dhe kuptimin e vet përfshin ndjenjat e njeriut duke i bërë atij thirrje në jetë – gjallëri. Në liturgji, muzika shenjte duhet të jetë mbështetje e lutjes; shprehje e misterit të Krishtit, e stolisur me shenjtëri dhe formë të mirë, me fjalë tjera t'i përgjigjet shpirtit të liturgjisë dhe të mos jetë pengesë në pjesëmarrjen e të gjithë besimtarëve në liturgji, si dhe vëmendjen dhe ndjenjat t'i drejtojë kah akti i shenjtë që kryhet. Edhe dokumenti post konciliar *"Instructio Musicam sacram"* në pikën 4a, jep kuptimin e muzikës së shenjtë për të cilën thotë: "Ajo është e krijuar për zhvillimin e shërbimit fetar, të cilin e stolisë shenjtëria dhe forma e rregullt". Edhe më konkretisht, në pikën 4b, theksohet se me emrin muzika shenjte, nënkuptohet këndimi gregorian, polifonia e vjetër dhe e re me të gjitha mënyrat e veta. Prandaj,

Muzika shenjte ka një kuptim më të gjerë se sa vetëm muzika apo këndimi liturgjik.

Udhëzimet e Koncilit II të Vatikanit për këndimin kishtar

Këndimi sakral që bazohet në fjalë apo tekste të përsëritshme, përpos vlerës artistike përbën edhe pjesën e liturgjisë së solemnë. Këtë e thekson Kushtetuta liturgjike *Sacrosanctum Concilium*, e cila vlerëson traditën e muzikës në Kishën e përgjithshme si thesar me vlerë të jashtëzakonshme (SC 112). Kjo Kushtetutë sjell disa udhëzime konkrete në lidhje me këndimin kishtar (SC 112-121).

Muzika e shenjtë do të jetë më e shenjtë, nëse ajo lidhet

kriteret për muzikën e shenjtë në liturgji: 1) Teksti i këngës kishtare duhet të jetë me karakter shpirtëror e jo laik. Kënga bën fjalë për Zotin dhe raportet tona ndaj tij, me qëllim që të na nxisë më shumë në fe, shpresë dhe dashuri, në lutje dhe sjellje të krishterë. Pra, muzika duhet të jetë e "shenjtë"; 2) Teksti i caktuar për këngët kishtare duhet të jetë në përputhje me mësimin katolik; do të jetë më e pëlqyeshme nëse tekstet merren nga Shkrimi i Shenjtë dhe nga burimet liturgjike; 3) Kënga duhet të jetë në rregull edhe për sa i përket aspektit gjuhësor; 4) Po ashtu, teksti duhet të jetë i qartë dhe i thjeshtë, e kjo vlen edhe për melodinë dhe ritmin e saj, për arsye se më lehtë mbahet mend.

i cili kremtohet; 9) Secila këngë që përdoret në liturgji, duhet të miratohet nga udhëheqësit e Kishës vendore.

Nëse ndonjë nga këto elemente i mungon këngës, ajo nuk duhet të radhitet në kantalet kishtare e as të përdoret në liturgji, por mund të përdoren në takime të ndryshme me karakter religjioz.

Shansonet shpirtërore

Sa u përket shansoneve me karakter shpirtëror të kohës sonë, duhet thënë se luajnë një rol të mirë në formimin dhe kultivimin e artit muzikor, mirëpo, mangësia më e madhe e tyre në aspektin liturgjik është se u nënshtrohen subjektivizmave, por edhe melosi dhe ritmi i tyre shpesh është jo



ngushtë me aktet liturgjike, qoftë kur ajo më këndshëm e shpreh lutjen, qoftë kur nxit bashkimin e shpirtërave, qoftë kur ritet e shenjtja i pasuron me më shumë solemnitet.

Muzika liturgjike apo kishtare, është vetëm ajo e cila me tekste, përmbajtje dhe formën e vet është e përshtatshme për ekzekutim në kremtimet solemnë liturgjike.

Duke u nisur nga udhëzimet pastorale e liturgjike të dokumenteve kishtare, fitojmë edhe

Kështu, pjesëmarrësit më lehtë kyçen në këndim; 5) Në liturgji nuk lejohet të përdoren këngë, të cilat nuk kanë kurfarë vlerë artistike. Të gjitha këngët duhet të kenë vlerën muzikore liturgjike; 6) Secila këngë kishtare duhet të krijojë pjesëmarrjen aktive të bashkësisë në aktet liturgjike; 7) Këngët duhet të jenë objektive e jo subjektive, sepse ato duhet të shprehin unitetin e bashkësisë; 8) Pastaj, kënga duhet të përkojë me kohën liturgjike, por t'i përshatet po ashtu misterit,

i zakonshëm dhe i rëndë. Pastaj, ato kryesisht janë të përkthyer nga gjuhë të huaja, kështu që, edhe pse mund të kenë një tekst të mirë, duhet menduar se sa u përshatën bashkësisë para së cilës interpretohen. Vërejtja më e madhe që u përshkruhet shansoneve, është se me këndimin e tyre po mbesin gjithmonë anash këngët e bukura me karakter popullor, të cilat mund të jenë edhe liturgjiksht, por edhe në aspektin pastoral më të përshatshme.

Është e vërtetë se shanset janë më argëtuese, por një këngë liturgjike nuk duhet të jetë e tillë. Në periudhën e Koncilit të II të Vatikanit dhe më vonë, amatorët muzikorë, por edhe muzikantët joprofesionistë, për fat të keq edhe meshtarë e motra, i japin vetit të drejtë, që, sipas shijes së tyre, ta orientojnë këndimin liturgjik drejt një këndimi më të lirë apo argëtues, duke harruar se kisha nuk është teatër, se liturgjia nuk është vetëm skenë teatrale apo argëtim.

Kisha, si këndim liturgjik i mban këto lloje: **a) Këngët korale** – Këndimi gregorian apo korali romak është këndimi i njëzëshëm në liturgjinë katolike. Deri në Koncilin e II të Vatikanit ishte këndimi zyrtar i liturgjisë katolike, por edhe tani mbetet në rend të parë si dhe shembull për format tjera të këndimit liturgjik. Thuhet se instrumenti më i mirë është pikërisht zëri i njeriut, i cili i këndon Zotit; **b) Këngët tradicionale**. Këto janë këngët që sipas traditës këndohen nga populli, pra bëhet fjalë për këndimin koral biblik si dhe këngët e lira kishtarë. Dallimi mes tyre është vetëm në tekst. Korali biblik parafrazon tekste nga Bibla dhe liturgjia, ndërsa këngët popullore kishtarë u drejtohen Zotit, shenjtërve, vendeve shenjte, mjeteve të ndryshme, jetës së përshtatshme etj. Në Kushtetuen liturgjike thuhet: “Le të përpunohet me zell këndimi popullor religjioz, që zërat e besimtarëve të kenë mundësi të kumbojnë në ushtrimet e përshtatshme dhe në aktet liturgjike, sipas udhëzimeve dhe normave në rubrika” (SC 118); **c) Polifonia**. Polifonia mund të ketë vend në liturgji por nëse i plotëson kushtet, të cilat i kërkon liturgjia shenjte. SC në numrin 116 mëson: “Kisha e konsideron këndimin gregorian si muzikë personale të liturgjisë romake; ajo pra në aktet liturgjike, me kushte të njëjta, ka vendin e vërtetë. Llojet tjera të muzikës së shenjtë, posaçërisht polifonia, asesi nuk përjashtohet nga kulti, përveç nëse i përgjigjen shpirtit liturgjik sipas art. 30; **ç) Muzika instrumentale** – Kulti i krishterë nuk kërkon patjetër instrumentet, për dallim nga këndimi. Mirëpo, në momente të caktuara mund të përdoren instrumente edhe pa kënduar, që sipas Koncilit e ndihmojnë lartësimin e shpirtit të njerëzve drejt Zotit.

Këndimi gjatë Meshës së shenjtë

Format e shërbesës liturgjike i dallojnë në ato sole mne dhe të thjeshta të riteve. Brenda këtyre dy formave, mund të ketë interpretime muzikore më tepër, varësisht sa i jepet hapësirë këndimit.

“*Instructio Musicam sacram*” 29-31 na mëson për pjesët e Meshës shenjte se si dallojnë në shkallëzim për sa i përket këndi-

mit. Kjo ka një rëndësi të veçantë, prandaj po përmend në pika të shkurta këtë shkallëzim:

Në rend të parë janë: a) Ritet fillestare: Përhëndetja e meshtarit me përgjigjen e popullit dhe lutja; b) Shërbesën e fjalës: Përthirrja ose eksklamacioni te Ungjilli; c) Shërbesa eukaristike: lutja mbi dhuratat, prefacioni dhe shenjt, doksologjia përfundimtare e kanonit, lutja Ati ynë me hyrje dhe shtesë, Paqja e Zotit, lutja pas kungimit dhe pjesa e lëshimit.



Uleset e korit në Katedralen e Aviles në Spanjë

“ Në liturgji, muzika shenjte duhet të jetë mbështetje e lutjes; shprehje e misterit të Krishtit, e stolisur me shenjtëri dhe formë të mirë, me fjalë tjera t’i përgjigjet shpirtit të liturgjisë dhe të mos jetë pengesë në pjesëmarrjen e të gjithë besimtarëve në liturgji, si dhe vëmendjen dhe ndjenjat t’i drejtojë kah akti i shenjtë që kryhet. ”

Së dyti, pjesë tjetër e këndimit në Meshë është: a) O Zot ki mëshirë, Lavdi dhe o Qengji Hyjit; b) Besojma; c) Lutja e besimtarëve, dhe në shkallë të tretë të këndimit janë: a) Këngët e hyrjes dhe të kungimit; b) Këngët pas leximeve ose Letrës; c) Aleluja para Ungjillit; ç) Kënga e paraqitjes së dhuratave; d) Pjesë nga Shkrimi i Shenjtë, të cilat mund të lexohen edhe pa u kënduar.

Kjo që u tha më lart, nuk do të thotë se nuk mund të ndërrohet ndonjëherë, varësisht nga solemniteti i ditës. Këtë na e vërtetojnë katër argumente: ai liturgjik, teologjik-letrar, pastoral dhe estetik. Liturgjik, sepse duhet t’i përshtatet kremtimit; teologjik-letrar, sepse më shumë disa pje-

sëve u përshtatet këndimi se sa recitimi, arsyeja pastorale qëndron në faktin se duhet të kihet parasysh bashkësia, e cila mund t’i këndoje me meshtarin vetëm ato pjesë të lehta, pra që të marrë pjesë në mënyrë më aktive gjatë shërbesës liturgjike; dhe estetik, sepse veç ndërimi i zërave krijon një atmosferë të këndshme gjatë kremtimit.

Në anën tjetër, secili pjesëmarrës në liturgji, duhet të kryejë atë që i takon, si meshtari ashtu edhe populli. Pra, fjala është për

kishë dhe kështu të shndërrohet këndimi në koncert, ndërsa populli të përjashtohet nga kjo pjesëmarrje, njëherësh, kjo nuk do të ishte as në frymën e asaj natyre të cilën e kërkon shërbesa liturgjike.

Për më tepër, është fakt antropologjik, se këndimi në grup përforcon unitetin e këngëtarëve dhe gjatë këndimit njeriu lirohet nga egoja e tij, u lëshohet rregullave që vijnë nga këndimi i përbashkët, ritmi, melodia, fjalët.

përkthuar me shpirtin e krishterë, të ndiejnë se janë të thirrur ta kultivojnë muzikën e shenjtë...” 121. Pra, gjatë punës ata duhet të ndjekin udhëzimet teologjike, liturgjike, muzikore e pastorale, e kjo vlen edhe kur këngët përkthehen prej gjuhëve të huaja.

Si mjete ndihmëse për zhvillimin sa më të mirë të këndimit janë të nevojshme psh. tekstet e këngëve, nëse ka kantuale e libra me këngë, ndërsa instrumenti që përcjell muzikën kishtarë, padyshim mbetet organoja si instrument kryesor, mirëpo mund të përdoren edhe instrumente tjera tradicionale që përshtaten me traditën e vendit. “Në Kishën latine duhet të ruhet organo si instrument tradicional, i cili me zërin e vet mund t’i japë riteve kishtarë shkëlqim imponant dhe të ngritë zemrat e besimtarëve të Hyji. Me vlerësimin dhe pëlqimin e autoritetit kishtar mbarështues të një territori të caktuar, lejohet edhe përdorimi i instrumenteve tjera në kulte aq sa përshtaten apo mund t’i përshtaten praktikës liturgjike dhe i përgjigjen dinjitetit të Shtëpisë së Hyjit...” SC 120.

Këngët kishtarë dhe ato liturgjike duhet t’i përgjigjen kohës (psh. nuk këndohen këngë të pashkëve gjatë kreshmëve), si dhe shpirtit të veprimit liturgjik (në fillim të meshës nuk këndohet kënga e kushtimit). Këngët e Zëmërs Krishtit ndonjëherë mund të mirren edhe si kënga e hyrjes.

Te psalmi mund të këndohet vetëm antifona, porositet që të këndohet edhe vetë psalmi. Këngët e ardhjes, Krishtlindjes, të kreshmëve apo edhe Pashkëve mund të përdoren gati në çdo pjesë të meshës, por duhet të shihet që së paku ndonjë prej tyre të jetë sa më e përafërt me ngjarjen gjatë meshës.

Në fund, duhet thënë se përgjithësisht, këndimi liturgjik nuk ka për qëllim të vetin vetëm ekzekutimin artistik, apo paraqitjen e estetikës dhe shijimit e saj, por ka për qëllim të mbështet njerëzit në lutje apo për një takim sa më të thellë me Zotin.

Duke çmuar lart punën e kompozitorëve tanë, si dhe të atyre që kanë kontribuar në kultivimin e artit muzikor kishtar në radhët e popullit tonë, urojmë që edhe në të ardhmen, të përkthuar nga shpirti i Zotit, të angazhohen në përfaqësimin sa më profesional të kantualeve kishtarë. Këtë na e sugjerojnë edhe Koncili i II të Vatikanit (SC 46) kur thotë: - Përveç këshillave liturgjike, të themelohen në të gjitha ipeshkvitë, aty ku është e mundur, edhe këshilla për muzikën dhe artin e shenjtë.

Për më tepër, nëse dokumentet e shumta të Kishës, muzikën apo këndimin liturgjik e quajnë të shenjtë, atëherë nuk ka dyshim se ajo i përfaqëton truqin besimtarit që ta përfaqëtojë thellësisht dashurinë e Zotit. “Kush këndon, lutet dy herë”.

rolet e ndryshme gjatë këndimit. Padyshim, kori e nxit këndimin në kishë, sepse ka një siguri më të madhe për këndim. Mirëpo, edhe meshtari, i cili është liturg dhe këngëtar i parë në kremtimin liturgjik, duhet të ketë kujdes për këndimin, sepse ai udhëheq. Ato pjesë, të cilat duhet t’i këndoje ai, nga meshtari duhet të këndohen në stilin gregorian, ashtu si janë në botimet tipike dhe ndalohej që ato t’i përcjellë ndonjë instrument. Ato duhet të thuhën qartë dhe me zë, ndërsa populli ka të drejtë dhe për denjë të përgjigjet dhe kështu të marrë pjesë sa më mirë në kremtimet liturgjike.

Faktin tjetër që duhet patur kujdes, është se kori nuk guxon të marrë gjithë këndimin në

Duhet të kihet kujdes që këngëtarët në kor, janë pjesë e popullit apo besimtarëve dhe kanë një rol të veçantë, që edhe ata të jenë të kyçur në liturgji, pra, t’u mundësohet pjesëmarrja e plotë sakramentale në meshë. Sot koret janë të vendosura në fund të kishës, ndërsa në të kaluarën kanë qenë në mes lterit dhe anijes kryesore si një urë në mes meshtarit dhe popullit. Këtë rol duhet ta ketë edhe tash.

Pastaj, pas meshtarit dhe xhakonit, psalmisti dhe kantori janë këngëtarët e parë në liturgji. Aty ku nuk ka kore, të paktën duhet të ushtrohen një apo dy këngëtarë, të cilët do të ndihmonin besimtarët në këndim. Për sa u përket kompozitorëve, SC thekson: “Kompozitorët duhet të jenë të



Gjithë juve miq dhe bamirës të dashur, ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xh-rolloqarive bankare.

 **Raiffeisen BANK**
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: BBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
 EUR: 1501 090000 1990 20
 USD: 1501 090000 3765 30
 CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë *"Drita"*. Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë "Dritën"** (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Emri: _____

Mbiemri: _____

Adresa: _____

Qyteti: _____

Kodi postar: _____

Numri i telefonit: _____

E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.



DRITA

"Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon."

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Shkator 2008 • Viti XXV • Nr. 9 (167) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3\$, SHBA \$2.50



**SHENJTËRORJA E ZOJËS
NË LETNICE – VEND
FEJE E BASHKIMI
E KREMTJA E ZOJËS
MADHE**
FAQE 2
(Shkruan:
DON AGIM QERETINI)



**KATEKEZA –
DETYRË E MBARË
KISHËS KATOLIKE**

PAGE 6-7

(Shkruan:
Dr. Dora Lleshi Gjoni)



**PËS
I NË
ZE KA
RËN DHE
NCEZËVE**



KËNDVESHTRIM
Edhe një fillim i vështirë i vitit shkollor

Svećenik koji se osuđuje zbog zločinâ iz prošlosti, a koji se ne može odvojiti od svojih djela, to je jedna od najtežih stvari koje se mogu dogoditi. U ovom slučaju, to je jedna od najtežih stvari koje se mogu dogoditi. U ovom slučaju, to je jedna od najtežih stvari koje se mogu dogoditi.

**Etosi
i Pleqnisë**
Atë Shtjefën Gjeçovi:
"Libri i njimbdhjetë
Kanuni i Pleqnisë"

FAQE 16-17

Shkruan:
Prend BUZHALA

Intervista me Mark Krasniqin
**Kisha katolike ka
pasur njerëz
të mëdhenj nga
radhët e klerit
në të gjitha fushat (II)**

